



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë”

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Asoc.Dr.Ilirjana Kaceli

Dr.Brikena Smajli

Korrik / 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në: “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e mesëm të Lartë”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gjuhës Sllave dhe Ballkanike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Mësuesi në gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të lartë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr.708 datë 19.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 194, datë 16.06.2023.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditim për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 Vite akademike /4 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip / turqisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (Shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2023 – 2024 10 PAE / 3 PAK Viti akademik 2024– 2025 10 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2021 – 2022 12 studentë; Viti akademik 2022 – 2023 9 studentë; Viti akademik 2023 – 2024 18 studentë; Viti akademik 2024 – 2025 7 studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në gjuhën Turke për Arsimin e Lartë të Mesëm” që ofrohet nga Universiteti i Tiranës është pjesë e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike. Programi është licensuar në bazë të Urdhërit Nr.708 datë 19.10.2018, të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Aktualisht programi i studimit po i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm në përmbushje të kushteve dhe kriterëve të legjislacionit në fuqi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja përbëhet nga shtatë departamente:

1. Departamenti i Gjuhë Angleze;
2. Departamenti i Gjuhës Frënge;
3. Departamenti i Gjuhës Gjermane;
4. Departamenti i Gjuhës Italiane;
5. Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike;
6. Departamenti i Gjuhës Spanjolle;
7. Departamenti i Gjuhës Greke;

Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve. Programi i Studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Lartë të Mesëm” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën Shqipe, 120 ECTS dhe kohë zgjatje të rregullt 2 vite akademike.

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Lartë të Mesëm” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me pedagogët e programit, GVJ konstatoi se ka një kujdes të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë profesionale duke marrë pjesë në aktivitetet dhe botimet kërkimore ndërkombëtare. Studentë e këtij programi studimi vlerësuan se ata mbështeten shumë nga stafi akademik duke u përfshirë në punën kërkimore të pedagogëve.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Programi Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” ofrohet nga njësia bazë Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Ky program është hapur me Urdhër MASR nr.708 datë 19.10.2018 me emërtim diplome Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” në sistemin 2 (dy) vjeçar me shkëputje nga puna.

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion gjatë vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë në mënyrë sa më reale, performimin e institucionit të FGJH-së dhe të departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike.

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga **Prof. Asoc. Dr. Ilirjana Kaceli** dhe **Dr. Brikena Smajli**. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Znj. Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të Jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetjeve, të cilat u realizuan gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat 17 dhe 18 Dhjetor 2024 sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL. Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Lartë të Mesëm”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të profesionistëve të rinj.

Universiteti i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.06.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 46/11 Prot, datë 19.06.2025. Universiteti i Tiranës njofton nëpërmjet sistemit më datë 10.07.2025, se nuk ka komente mbi draft raportin. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	UT si institucion i Arsimit të Lartë, ofron programe studimi të cilat janë në përputhje me interesat kombëtare. Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike zhvillon programe studimi në të tre ciklet: Bachelor, Master Shkencor dhe Doktoraturë. Studimet e ciklit të tretë (Doktoratura) organizohen në nivel ndërdepartamental, me mbështetjen e institucionit të arsimit të lartë që nga viti 2015. Programet e studimit të këtij departamenti janë hartuar dhe ofrohen në përputhje të plotë me misionin e arsimit të lartë, Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021–2026, ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me rolin dhe misionin e Universitetit të Tiranës. Këto programe respektojnë gjithashtu Planin Strategjik të Universitetit të Tiranës (2018–2023) Strategjinë për Zhvillimin e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, si dhe Rregulloren e programeve të studimit të Universitetit të Tiranës Universiteti i Tiranës, si universitet publik, realizon misionin e tij përmes edukimit, kërkimit shkencor dhe shërbimit ndaj publikut, duke vendosur studentin në qendër të procesit mësimor dhe duke nxitur zhvillimin personal, intelektual dhe qytetar të tij në një shoqëri globale. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dhe Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike si pjesë e tij, angazhohet të përmbushë këto objektiva duke përshtatur programet e studimit me nevojat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit. Në këtë kuadër, programi i studimit është në përputhje me interesat kombëtare dhe kontribuon në përmbushjen e tyre. Evidenca <i>Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018-2023.pdf,</i>



	<i>Evidenca 1.5. Strategjia për zhvillimin e FGJH.pdf, f. 3.</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e programit mësimor Master Shkencor Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf.</i> <i>Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit të Tiranës,</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e zhvillimit të UT-së 2023-2028,</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në përputhje me misionin e Universitetit të Tiranës për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë dhe për të ndërtuar procesin mësimor mbi traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, të ndërthurura me arritjet bashkëkohore ndërkombëtare, kurrikula e programit të studimit është hartuar në përputhje të plotë me zhvillimet shkencore brenda dhe jashtë vendit. Ajo synon të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj nevojave dhe kërkesave të shoqërisë shqiptare. Evidencë <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FGJH-së.pdf, f. 18</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Në përputhje dhe përshtatje me strategjinë e zhvillimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe atë të Universitetit të Tiranës, programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” synon të formojë studentë me cilësi, vlera e kompetenca, si dhe të aftë të kontribuojnë në sektorin e mësimdhënies së gjuhës turke në arsimin e mesëm të lartë në veçanti, të fushës së përkthimit dhe atë të zhvillimit të shoqërisë në tërësi. Universiteti i Tiranës ofron programe në nëntë fusha të ndryshme, ndër të cilat janë edhe gjuhët e huaja. Veprimtaria e departamenteve që ofrojnë këto programe është hartuar e strukturuar në përputhje me drejtimet akademike të UT-së dhe FGJH-së, me Statutin e UT-së si dhe me rregulloren e FGJH-së dhe rregulloren e UT-së. GVJ-ja konstaton se programi Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” ofrohet në përputhje me strategjinë e Institucionit, Statutin dhe rregulloren e tij, me rregulloren e njësisë kryesore si dhe në përputhje me drejtimet akademike të institucionit dhe të njësisë kryesore. Evidenca

	<i>Evidencë 1.1 Statuti i IAL.pdf</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023-2028,</i> <i>Evidencë 1.5. Strategjia për zhvillimin e FGJH.pdf, f. 5, 7, 9.</i> <i>Evidencë 3. Rregullore e programim mësimor Master Shkencor në Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” që ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në përputhje me statutin e Universitetit të Tiranës, është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe të kërkimit shkencor e inovacionit. Gjithashtu ky program është në përputhje me prirjet globale të zhvillimit dhe me objektivat e kornizës “Edukimi dhe Trajnimi 2020” në fushën e arsimit dhe formimit, dhe me kuadrin e ri të Bashkimit Evropian për kompetencat themelore për të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe me objektivin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Evidencë <i>Evidenca 1.11. Strategjia e Ndërkombëtarizimit të FGJH-së,</i> <i>Evidenca 1.12 Strategjia Kombëtare e Arsimit</i> <i>Evidenca 1.5. Strategjia për zhvillimin e FGJH.pdf</i>
Konkluzione	GVJ – ja konstaton se: programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” që ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike hartohet dhe zhvillohet në përputhje të plotë me misionin e Universitetit të Tiranës, strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe dokumentacionin ligjor e rregullator vendas dhe ndërkombëtar. Bazuar në analizën e dokumentacionit evidencave dhe përshkrimin e dhënë, konstatohet gjithashtu se programi reflekton objektiva të qarta profesionale dhe formuese, të cilat lidhen drejtpërdrejt me nevojat e zhvillimit lokal, kombëtar dhe global, duke pasur në thelb edukimin ndërkulturor, aftësitë komunikative dhe përshtatshmërinë ndaj tregut të punës. Gjithashtu, mekanizmat e rishikimit të programeve në baza vjetore, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, garantojnë përshtatjen dinamike të kurrikulave me kërkesat e tregut dhe zhvillimet shkencore bashkëkohore.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, i ofruar nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, është një ndër iniciativat më të rëndësishme pedagogjike të zbatuara gjatë katër viteve të fundit. Ky program synon përgatitjen e specialistëve të fushës në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe objektivat strategjike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja për zhvillimin e arsimit të mesëm të lartë në Shqipëri. Departamenti që ofron këtë program përfaqëson një strukturë akademike me përvojë të gjatë dhe të konsoliduar, duke qenë njësi më e vjetër brenda Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, me një histori 60-vjeçare. Kjo përvojë përbën një garanci për cilësinë e procesit mësimor dhe përmbajtjes akademike që i ofrohet studentëve. Përgjatë viteve, sidomos pas reformave administrative dhe pedagogjike të viteve '90, departamenti ka njohur një proces të vazhdueshëm përmirësimi, duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave dhe modernizimin e qasjeve mësimdhënëse. Një rol të veçantë në forcimin e këtij programi ka luajtur edhe bashkëpunimi me departamente simotra në universitete brenda dhe jashtë vendit, çka ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së stafit akademik dhe përmbajtjes së programeve. Ekspertiza e ndërtuar ndër vite dhe tradita e bashkëpunimeve akademike e vendosin këtë departament në një pozitë të favorshme për të garantuar standarte të larta cilësie, si në përmbajtjen e programit, ashtu edhe në përgatitjen profesionale të stafit. Në këtë kuadër, programi në Mësuesi për Arsimin e Mesëm të Lartë përbën një shembull të mirë të zbatimit të strategjive institucionale në fushën e arsimit dhe përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

	Evidenca <i>Evidenca 5. Vendimi i dhënies së lejes për programin e Masterit.pdf</i> <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca Nr 1.13, Akreditimi, Vendim nr.04. dt, 27.01.2023</i> <i>Evidenca 1.9 Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2021-2022</i> <i>Evidenca 1.10 Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, është kodifikuar si 72MS0111X, sipas evidencës zyrtare të paraqitur në dokumentin “Evidencë I.16_Kodifikimi i programeve Master.pdf”, f. 3, si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 31, datë 14.07.2022, të MASR, “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky kodifikim identifikon në mënyrë të qartë fushën e përgjithshme dhe specifike të programit, e cila është në përputhje të drejtpërdrejtë me fushën akademike dhe kërkimore të njësive kryesore përgjegjëse për programin e studimit – në këtë rast, Departamenti përkatës dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Përputhshmëria midis klasifikimit të programit dhe profilit akademik/kërkimor të njësive që e ofron është e dukshme dhe dokumentuar, duke garantuar koherencë midis objektit të studimit dhe kapaciteteve institucionale përkatëse. Gjithashtu, përputhshmëria me klasifikimet evropiane është e nënkuptuar në faktin që Udhëzimi nr. 31 është ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kodifikimit të fushave të studimit, duke siguruar që programi të jetë i krahasueshëm dhe i barasvlershëm me programet e ngjashme në vendet e tjera të Europës. Evidenca <i>Evidenca, Udhëzimi nr. 31, 2022, “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> <i>Evidenca I.16_Kodifikimi i programeve Master.pdf, f. 3</i> <i>(Kodifikimi: 72MS0111X)</i>

	<i>Evidenca I.7_Rregullore e FGJH-së.pdf</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e programim mësimor Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	GVJ-ja, duke u bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit në DVV dhe shënimet e marra gjatë vizitës në institucion, konstaton që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Nga ana tjetër cilësia e programit të studimit "Master i Shkencave në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" garantohet nga institucioni nëpërmjet NJSBC-së. Evidenca <i>Evidenca I.7_Rregullore e FGJH-së.pdf</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e programim mësimor Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i> <i>Evidenca, Shenime UT, FGJH.pdf</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Në përmbushje të objektivave për zhvillimin profesional të studentëve të diplomuar dhe në bashkëpunim me punëdhënësit, Universiteti i Tiranës ka themeluar Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit. Kjo qendër synon të identifikojë nevojat për edukim të vazhdueshëm dhe të organizojë programe të shkurtra trajnimi për zhvillimin e kompetencave të reja profesionale. Programet e ofruara ndërtohen mbi bazën e konsultimeve me punëdhënësit dhe partnerët institucionalë, duke siguruar që përmbajtja e trajnimeve të jetë në përputhje me zhvillimet aktuale të tregut të punës dhe me kërkesat reale të sektorëve profesionalë. Krahas kësaj, Qendra ofron shërbime të këshillimit profesional dhe ekspertizë të specializuar, të mbështetura në rezultatet e punës kërkimore-shkencore të stafit akademik të UT-së. Informacioni mbi aktivitetet, trajnimet dhe programet e zhvillimit profesional të organizuara nga kjo qendër

	publikohet rregullisht në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës, në rubrikën “Qendra e Trajnimit”, duke garantuar transparencë dhe akses për të gjithë të interesuarit. Evidenca <i>Evidencë 1.17_Vendim nr.48 për Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit.pdf</i> https://unitir.edu.al/qender-virtuale-e-trajnitimit-dhe-zhvillimit-profesional/			
Konkluzione	<i>Programi i ciklit të dytë Msc në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, i ofruar nga Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike në Universitetin e Tiranës, përfaqëson një nismë të rëndësishme akademike, e mbështetur në një përvojë 60-vjeçare dhe në një strukturë të konsoliduar institucionale. Programi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse, si dhe synon përgatitjen e specialistëve në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe objektivat strategjike të fakultetit.</i> <i>Forcimi i cilësisë së programit mbështetet nga bashkëpunimet akademike dhe nga resurset e brendshme të departamentit, ndërsa zhvillimi profesional i studentëve të diplomuar përkrahet nga Qendra Virtuale e Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit, e cila ofron kurse të shkurtra dhe këshillim në bashkëpunim me punëdhënësit. Programi përmbush plotësisht kriteret e cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe	GVJ-ja konstaton se: Institucioni siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda tij për hartimin, mbikëqyrjen dhe

mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	mbarëvajtjen e programit brenda institucionit. Kjo vihet re tek lëndët e përbashkëta në programin e studimit <i>Gjuhë C</i>, që u përgjigjet nevojave të përbashkëta të të gjitha departamenteve, si edhe një bashkëpunim edhe më i gjerë tek Masteri ndërdepartamental i përkthim interpretimit, në të cilin anëtarët e stafit të departamentit janë të përfshirë me lëndët përkatëse. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf, Evidenca 1.10_Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2022 - 2023.pdf</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ -ja konstaton se, për realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit. Në mënyrë të veçantë, njësia përgjegjëse për programin e studimit ka ndërmarrë hapa konkretë për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për të lidhur procesin akademik me tregun e punës. Në këtë kuadër: • Janë zhvilluar takime me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri-Turqi (ATTSO), me fokus punësimin e studentëve dhe përmirësimin e lidhjes midis studimeve universitare dhe praktikave të tregut. • Janë krijuar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe ndërkombëtare, aktorë të biznesit kombëtar dhe të huaj, me qëllim mbështetjen e objektivave të programit të studimit në Gjuhën Turke. • Departamenti ka vendosur bashkëpunim të vazhdueshëm akademik dhe institucional me disa universitete prestigjioze në Turqi, si: ○ Universiteti Bardin ○ Universiteti i Anadollit ○ Universiteti Çukurova ○ Universiteti Mehmet Akif Ersoy Këto marrëdhënie janë krijuar me qëllim realizimin e objektivave të programit dhe përfaqësojnë një angazhim të qëndrueshëm në drejtim të ndërkombëtarizimit dhe të forcimit të përvojës akademike të studentëve në fushën e Gjuhës Turke.

	Evidenca <i>Evidencë I.19_Memorandume Bashkëpunimi për Praktikën Mësimore dhe Profesionale.pdf</i> <i>Marrëveshje të UT-së me kompani dhe institucione të tjera (homologe).pdf</i> <i>Evidencë IV.12 Lista e Marrëveshjeve të nënshkruara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja për praktikën e Masterave Shkencore.pdf</i> <i>Evidencë I.10_Raporti vjetor mësimor-kërkimor 2022 - 2023.pdf</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	GVJ-ja konstaton se praktika mësimore për studentët e këtij programi realizohet në mënyrë të strukturuar, mbi bazën e marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe institucioneve pritëse arsimore. Këto marrëveshje sigurojnë baza të qëndrueshme bashkëpunimi dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin cilësor të praktikës profesionale të studentëve. Në këtë kuadër, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) Tiranë, ka zbatuar me përpikëri procedurat për zhvillimin e praktikës. Janë dërguar në kohë listat zyrtare të studentëve që kryejnë praktikën, kryesisht në gjimnaze me profil gjuhësor, si: • Shkolla e Mesme e Bashkuar “Asim Vokshi” • Gjimnazi “Turgut Özal” • Gjimnazi “Ibrahim Dalli” Për zhvillimin e praktikës hartohet një program i posaçëm, që ndjeket dhe mbikëqyret nga pedagogë të caktuar për këtë qëllim. Dokumentacioni i praktikës përfshin: • Marrëveshjet ndërinstitucionale • Listat emërore të studentëve praktikantë • Vërtetimet individuale për pjesëmarrje në praktikë të lëshuara nga njësia përkatëse (FGJH) • Formularët e vlerësimit të mbushur nga institucionet pritëse Ky proces është dokumentuar dhe mbështetur me evidence. Ky organizim dëshmon angazhimin institucional për sigurimin e kushteve reale të mësimdhënies dhe përgatitjen profesionale të studentëve në përputhje me objektivat e programit të studimit.


	Evidenca <i>Evidenca III.49.1 – III.49.4: Dokumentacioni i praktikës</i> <i>Evidenca III.50: Materiale mbështetëse për studentët gjatë praktikës (shtojca .pdf)</i> <i>Evidenca IV.12: Lista e marrëveshjeve të nënshkruara për programet master</i> <i>Evidenca 9. Marrëveshje bashkëpunimi në rang fakulteti (pdf)</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	GVJ-ja konstaton se njësia përgjegjëse për programin e studimit realizon në mënyrë periodike raporte analitike mbi përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e bashkëpunimit ndër institucional. Bazuar në materialet në DVV, GVJ-ja konstaton se Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, harton raporte periodike kryesisht vjetore ku analizon dhe raporton përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të objektivave të programit të studimit. Në këto raporte përfshihen të dhëna për marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e mobilitetit të stafit dhe brenda vitit 2021-2022 janë realizuar 30 të tilla në fakultetin e gjuhëve të huaja. Ndërsa në vitin 2023-2024 janë realizuar po nga FGJH në funksion të realizimit të këtij programi studimi, dy marrëveshje bashkëpunimi për mësimdhënien e gjuhës turke, me shkollën jopublike “Hafiz Ibrahim Dalliu” dhe me kolegjin jopublik “Turgut Ozal Education “Sh.A. Evidenca <i>Raporti vjetor për vitin akademik 2019–2020</i> <i>Raporti vjetor për vitin akademik 2020–2021</i> <i>Evidenca shtesë 10. Marrëveshje bashkëpunimi në rang fakulteti.pdf.</i> <i>Evidenca 7.6. Raport Vjetor për Sigurimin e Cilësisë (ff. 47–48)</i> <i>Evidenca, 17. 16. Raport për Kërkimin Shkencor (f. 29)</i> <i>Evidenca, V.18 26.12.2023 Per miratimin e raportit te veprimtarise mesimore, kerkimore shkencore dhe financiare te UT, 2022-2023.pdf</i>
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se: programi i studimit “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” zhvillohet në një kontekst të konsoliduar bashkëpunimi, si brenda ashtu edhe jashtë institucionit. Bashkëpunimi i brendshëm

	ndërmjet departamenteve përmes përfshirjes në lëndë të përbashkëta dhe pjesëmarrjes në programe ndërdepartamentale, dhe ndër disipline dëshmon një qasje të koordinuar dhe efektive për garantimin e cilësisë akademike. Gjithashtu, institucioni ka ndërmarrë hapa të qarta dhe të dokumentuara për të zhvilluar partneritete me aktorë të tregut të punës dhe institucione ndërkombëtare, duke përfshirë universitete të njohura në Turqi. Këto marrëdhënie përfaqësojnë një angazhim të qëndrueshëm për ndërkombëtarizimin e programit dhe për përgatitjen e studentëve në përputhje me kërkesat e tregut. Njësia përgjegjëse zhvillon periodikisht analiza mbi përfitimet nga bashkëpunimet ndërkombëtare dhe mobilitetet studentore, duke reflektuar dhe përcaktuar orientime për përmirësim të mëtejshëm të procesit formues.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë	GVJ-ja konstaton se programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, ofrohet në përputhje me ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), <u>por nuk është në përputhje me ndarjen e</u>



përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

veprimtarive formuese sipas përcaktimit në VKM 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me vendim nr. 185, datë 25.03.2021.

Referuar Urdhërit për hapjen e Programi të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, në Universitetin e Tiranës konstatohet se programi është i organizuar në 2 vite akademike dhe në 4 semestra me nga 30 ECTS secili, në total 120 ECTS.

Megjithatë, vihet re mospërputhje mes kësaj evidence dhe dokumentit të kërkuar gjatë vizitës në institucion (evidence shtesë nr. 3 Plani mësimor Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, i ndarë sipas veprimtarive formuese nuk është në përputhje me VKM 41). Sipas këtij dokumenti programi është me 120 ECTS, dhe veprimtaria formuese e programit të studimit ndahet sipas kategorive B,C,D, dhe E është si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit të marrë mbas vizitës në institucion (Plani mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë) GVJ konstaton se ndarja e planit mësimor sipas veprimtarive formuese është si më poshtë vijon:

Kategoria	Tipi	ECTS	%	Standardi
A	Lëndë Bazë	0	0%	5% -10 %
B	Lëndë karakterizuese	60	50 %	50% -60 %
C	Lëndë ndërdisiplinore / integruese	22	18.3 %	12% -20%
D	Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale	20	16.6 %	10 %
E	Detyrime përmbyllëse/ Provimi perfundimtar	18	15 %	10%-15 %

	Nga sa më sipër konstatohet se: - nuk ka lëndë mësimore të kategorisë A (Lëndë bazë) në Planin Mësimor të shprehura në 0 % të krediteve, në raport me 5% - 10% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; - gjenden më shumë lëndë mësimore të kategorisë D (Lëndë plotësuese/ Praktika profesionale) në Planin Mësimor të shprehura në 16.6 % të krediteve, në raport me 10% kredite të përcaktuara në VKM, nr. 41/2018 për këtë kategori; <i>Për sa më sipër GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</i> <i>Njëkohësisht të ndryshojë edhe plani mësimor deri në masën 20% që është kërkuar nga vetë institucioni dhe miratuar me vendim senati nr.25 datë 04.05.2023 sipas kërkesës së vetë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja kishte për programet Master.</i> Programi i referohet niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është i harmonizuar me objektivat e formimit profesional dhe akademik të mësuesve, si dhe me emërtimin e diplomës përkatëse. Shpërndarja e krediteve është e përshtatshme dhe në përputhje me praktikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Evidenca <i>Evidenca, 2. Plani mësimor Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i> <i>Evidenca, 14. Programet Mësimore Master Shkencor gjuhë turke.pdf</i> <i>Evidenca 2. Plani mësimor Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i> <i>Plani mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë;</i> <i>Evidenca; II.16 Miratim i ndryshimeve në programin MA vendim rektori</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale	Programi i studimit "Master i Shkencave", në "Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" është në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe synon formimin e mësuesve të gjuhës turke për arsimin e mesëm të lartë. Ky

specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	program siguron përgatitje gjuhësore, kompetenca komunikimi dhe njohuri në metodologjinë dhe didaktikën e mësimdhënies, duke i pajisur studentët me aftësi të nevojshme për ushtrimin e profesionit të mësuesit. Struktura e programit është e organizuar në dy vite studimi dhe përfshin lëndë teorike dhe praktike që mbulojnë fusha të ndryshme, si metodologjia e mësimdhënies, psikologjia e edukimit, psikolinguistika, zhvillimi i kurrikulës, menaxhimi i klasës, vlerësimi i nxënësit, gjuhësia e zbatuar, komunikimi ndërkulturor, përdorimi i TIK-ut në mësimdhënie, si dhe praktika profesionale dhe përgatitja e provës përfundimtare. Programi vendos theks të veçantë në zhvillimin e mendimit kritik dhe qasjes shkencore ndaj njohurive, duke synuar jo vetëm përvetësimin e tyre, por edhe aftësimin për reflektim dhe aplikim në situata reale mësimore. Thellimi i njohurive arrihet përmes lëndëve karakterizuese që integrojnë aspektet gjuhësore, pedagogjike dhe komunikative. Gjithashtu, programi promovon zotërimin e avancuar të gjuhës turke nëpërmjet lëndëve praktike, si dhe përforcon rëndësinë e praktikës profesionale, e cila zhvillohet nëpërmjet leksioneve, seminareve, detyrave individuale dhe bashkëpunimeve institucionale brenda dhe jashtë vendit. Kjo qasje i ndihmon studentët të zhvillojnë kompetenca gjuhësore dhe pedagogjike në një mjedis reflektues dhe kritik. Në përmbledhje, ky program synon formimin e plotë të mësuesve të ardhshëm të gjuhës turke, duke integruar njohuritë teorike me ato praktike, në funksion të përgatitjes për sfidat e arsimit bashkëkohor. Evidenca <i>Evidenca, Programet e turqishtes_SKM_C257i24112012450.pdf</i> <i>Evidenca, 2. Plani mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesë të lartë.pdf</i> <i>Evidenca, 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të	GVJ-ja konstaton se programi i studimit ka të përcaktuara qartë ngarkesat në kredite ECTS për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Në planin mësimor të programit "Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë", janë të përcaktuara kreditet për



detyrimeve përmbyllëse.	Përvojën praktike (seksioni D) 12 ECTS, si dhe për Proven finale (seksioni E) 18 ECTS, në përputhje me kërkesat standarde të ciklit të dytë të studimeve. Evidenca <i>Evidenca, Plani mësimor – Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i> <i>Evidenca 1.9, Raporti vjetor mësimor kërkimor 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.10, Raporti vjetor mësimor kërkimor 2022-2023;</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Sipas vlerësimit të kryer, programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” është i strukturuar si një program i ciklit të dytë të studimeve, në përputhje me fushat përkatëse të formimit profesional dhe akademik. Ky program ofrohet ekskluzivisht nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, në kuadër të Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, konkretisht nga Dega e Gjuhës Turke. Përfundimi me sukses i këtij programi u mundëson të diplomuarve të ushtrojnë profesionin e mësuesit të gjuhës turke në arsimin e mesëm të lartë, si në institucionet arsimore publike dhe jopublike në vend, ashtu edhe në institucione arsimore turke që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Evidenca <i>Evidenca, Plani mësimor – Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i> <i>Evidenca 1.9, Raporti vjetor mësimor kërkimor 2021-2022;</i> <i>Evidenca 1.10, Raporti vjetor mësimor kërkimor 2022-2023;</i>
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së	GVJ-ja konstaton se programi i studimit “Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” është i strukturuar në dy vite akademike dhe me 120 kredite ECTS dhe përmban 25% të krediteve të dedikuara formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Në përputhje me standardet kombëtare, programet “Master” që përgatisin mësues në të njëjtën fushë të mësuesisë duhet të kenë së paku 80% të kurrikulës me përmbajtje të përafëruar. Programi në fjalë përmbush këtë kriter përmes organizimit të moduleve themelore dhe të specializuara.

paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Kurrikula përfshin lëndë nga fusha e edukimit, psikologjisë dhe metodologjisë së mësimdhënies, si: • <u>Formimi psiko-pedagogjik</u>: Metodologji e mësimdhënies dhe të menduarit kritik (C), Psikologji zhvillimi I (B), Psikologji edukimi (B), Psikolinguistikë (B), Të nxënit dhe menaxhimi i klasës (C), Zhvillimi i kurrikulës (C), Vlerësimi i nxënësit (B), Metodologji kërkimi shkencor në konceptimin pedagogjik të gjuhës së huaj (B). • <u>Formimi gjuhësor dhe didaktik</u>: Metoda dhe metodologji të mësimdhënies së gjuhës së huaj (B), Gjuhësi e zbatuar (B), Komunikimi ndërkulturore (B), Testimi dhe vlerësimi në gjuhën B (B), Gjuhë e huaj C – Niveli i avancuar I & II (D), Gjuhë e huaj për qëllime specifike (B), Përdorimi i drejtë i gjuhës turke (B), TIK në mësimdhënie të gjuhës së huaj (B). • <u>Komponentët praktikë dhe përmbyllës</u>: Përvojë praktike (D), Laborator teorik dhe praktik për hartimin e provës finale (B), Prova finale (E). Duke qenë një program relativisht i ri, ai është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në kontekstin e riorganizimit të strukturës së studimeve, nuk janë bërë ndryshime thelbësore në përmbajtjen e lëndëve kryesore, përveç riemërtimit të tre prej tyre për qëllime harmonizimi me strukturat standarde. Evidenca <i>Evidenca, Plani mësimor – Master Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.pdf</i>
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë	Pranimi i studentëve dhe mënyra e financimit në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe me dispozitat specifike të parashikuara në kuadrin ligjor të Ministrisë përgjegjëse për arsimin. Programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” është i hapur për shtetas shqiptarë dhe të huaj, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet institucioneve arsimore përkatëse. Pranimi në këtë program realizohet në bazë të kuotave dhe

përgjegjëse për arsimin.	udhëzimeve të përcaktuara çdo vit akademik nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, përmes akteve nënligjore përkatëse. Për t'u regjistruar në programin e studimit "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë", kandidatët duhet të kenë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve. Pranohen gjithashtu kandidatët që zotërojnë një diplomë të arsimit të lartë në gjuhën turke, ose një diplomë ekuivalente nga një institucion i huaj, në përputhje me rregulloren e brendshme të programit të studimit. Evidenca <i>Evidenca: Statuti i Universitetit të Tiranës;</i> <i>Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 20.4.2018 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë ose për transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2018-2019".</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në këtë fushë studimi programi është unik dhe nuk ka të ngjashëm me të në asnjë prej IAL të vendit tone. Për këtë arsye ky kriter nuk aplikohet në këtë rast.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ-ja konstaton se programi i studimit "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë", që ofron Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike dega e Gjuhës turke, është kodifikuar sipas fushës së studimit dhe klasifikimit të bërë publik nga Ministria e Arsimit dhe Sportit nr.704 datë 17.10.2008. Ky program i përket nivelit të shtatë të kualifikimeve, është dy-vjeçar, në fushën e arteve dhe humaniteteve, me fushë të ngushtë të papërcaktuar 72MS011 X. Kodifikimi i lëndëve të programit nuk është realizuar.
	Evidenca <i>Evidenca 1.15 Urdhër për hapjen e programeve të ciklit të dytë;</i> <i>Evidenca 1.16 Kodifikimi i programeve Master</i>



Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	GVJ-ja konstaton se programi i studimit bën pjesë në programet e përbashkëta të bashkëpunimit ndërinstitucional, të zhvilluara midis institucioneve të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. Studentët e ciklit të dytë, në programin "Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë", kanë përfituar nga mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar, duke marrë pjesë në programin Erasmus+ në vende si Bullgaria dhe Turqia. Gjithashtu, ata janë angazhuar në shkolla verore dhe programe online për përmirësimin e njohurive në gjuhën turke, të organizuara nga Universiteti i Bilkentit. Evidenca <i>Evidenca 10. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit në kuadër të Erasmus+.pdf.</i>			
Konkluzione	GVJ-ja konstaton se programi i studimit "Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" është ndërtuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi (Ligji nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore), i harmonizuar me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe praktikat europiane të ECTS. Programi është strukturuar në dy vite akademike, me 120 kredite ECTS, dhe përmban një plan mësimor të balancuar mes përmbajtjes teorike dhe praktike. Ai përfshin të gjitha komponentët kryesorë të formimit të mësuesve: përgatitjen gjuhësore të avancuar në gjuhën turke, kompetencat didaktike dhe metodologjike, si dhe përvojën praktike profesionale dhe provën përfundimtare. Rreth 25% e krediteve i dedikohen formimit psiko-pedagogjik, në përputhje me standardet kombëtare për programet e mësuesisë. Për sa më sipër GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Në përfundim, programi përmbush kriteret e një cikli të dytë studimesh dhe ofron një formim të plotë profesional dhe akademik për mësuesit e ardhshëm të gjuhës turke.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UT, ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.04, datë 27.01.2023 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, deri në 26.01.2029. Fakultetit të Gjuhëve të Huaja si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 7 njësi bazë: 1. Departamenti i Gjuhës Angleze; 2. Departamenti i Gjuhës Frënge; 3. Departamenti i Gjuhës Italiane; 4. Departamenti i Gjuhës Gjermane; 5. Departamenti i Gjuhës Spanjolle; 6. Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike; 7. Departamenti i Gjuhës Greke; Referuar dokumentacionit të dërguar nga institucioni pas vizitës që GVJ kreu në institucion (<i>Tabelat e RVB në gjuhën shqipe</i>), rezulton se Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike ka këto të dhëna për tsafin akademik për tre vite akademike. <table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2021-2022</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>7</td><td>1</td><td>7</td><td>1</td><td>5</td></tr><tr><td>Totali</td><td>10</td><td>7</td><td>10</td><td>7</td><td>10</td><td>5</td></tr></table>	Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-	Prof. Asoc.	6	-	6	-	6	-	Dr./PhD.	3	-	3	-	3	-	Msc.	1	7	1	7	1	5	Totali	10	7	10	7	10	5
Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-																																											
Prof. Asoc.	6	-	6	-	6	-																																											
Dr./PhD.	3	-	3	-	3	-																																											
Msc.	1	7	1	7	1	5																																											
Totali	10	7	10	7	10	5																																											

	Evidenca <i>Evidenca, 7. Lista e stafit me kohë të plotë e departamentit dhe stafit të mësimdhënies në këtë program.pdf</i> <i>Tabela 1-8 përmbledhëse në dokumentet e derguar pas vizitës në institucion</i> <i>Tabela 2 përmbledhëse e personeli akademik të brendshëm dhe të jashtëm</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e ciklit të dytë Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" është Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (FGJH), në përbërje të Universitetit të Tiranës. Brenda FGJH-së, Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, përmes Njesisë së Gjuhës Turke, përmbush të gjitha detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 80/2015, si dhe në aktet nënligjore në fuqi për ofrimin dhe menaxhimin e programeve të studimit. Në funksion të realizimit të praktikave mësimore dhe komponentëve të tjerë formues, Njësia angazhon personel ndihmës akademik dhe administrativ, duke përfshirë specialistë për koordinimin e praktikave, sekretariatit mësimor dhe mbështetës teknik për nevoja të posaçme të programit. Ky personel kontribuon në: • organizimin dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në shkollë të mesme publike; • koordinimin me mësues bashkëpunëtorë në terren; • mbajtjen e dokumentacionit për çdo student praktikant; • mbështetjen logjistike dhe organizative për komponentët e integruar të praktikës pedagogjike. Gjithashtu, janë në funksion marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore parauniversitare publike, të cilat sigurojnë terren praktik për studentët. Këto marrëveshje janë aktive dhe të përditësuara, duke garantuar realizimin në kohë dhe me cilësi të praktikave mësimore. Në përputhje me standardet për akreditim dhe cilësinë në arsimin e lartë, njësia përkatëse dokumenton dhe monitoron të gjitha aspektet e zbatimit të praktikës profesionale, duke garantuar përfshirjen efektive të personelit të nevojshëm për realizimin e këtij komponenti të rëndësishëm formues.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin cakton një koordinator për çdo program studimi, i cili është përgjegjës për

për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, përkatësisht Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 25 pika 3, si dhe bazuar në Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (FGJH) dhe Rregulloren e Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, për secilin program studimi është i përcaktuar një Koordinator Programi, i cili ushtron përgjegjësi të qarta në drejtim të ecurisë, zhvillimit dhe mbikëqyrjes së praktikave profesionale të programit. Për programin e ciklit të dytë “Master i Shkencave – Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, përgjegjësia për organizimin, funksionimin dhe zhvillimin i takon Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike. Brenda këtij kuadri, koordinatori i programit dhe grupi kërkimor-shkencor janë struktura kyçe që sigurojnë zbatimin e strategjisë së zhvillimit të programit, hartimin dhe përditësimin e dokumentacionit përkatës, përfshirë rregulloret e brendshme, përmbajtjen mësimore dhe objektivat e tij akademikë e profesionale. Ndër detyrat e koordinatorit përfshihen: • Monitorimi i ecurisë së regjistrimeve dhe transferimeve të studentëve; • Mbikëqyrja e realizimit të praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore; • Koordinimi i punës me pedagogët për garantimin e përmbushjes së objektivave të programit; • Raportimi periodik tek përgjegjësi i Departamentit mbi progresin dhe nevojat e programit. Gjithashtu, koordinatori bashkëpunon ngushtësisht me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë FGJH-së, e cila ofron mbështetje në proceset e vlerësimit të brendshëm, analizat cilësore të programit, mbledhjen e të dhënave nga studentët dhe stafi, si dhe në hartimin e raporteve për përmirësim të vazhdueshëm. Kjo njësi, në bashkëpunim me strukturat përkatëse të fakultetit dhe të universitetit, si dhe me institucione të jashtme si Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL),
--	---

	garanton respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe përmbushjen e objektivave të programit në përputhje me misionin institucional. Evidenca <i>Vendimi për caktimin e koordinatorit të programit;</i> <i>Rregulloret përkatëse të FGJH-së dhe të Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike;</i> <i>Raportet dhe analizat vjetore të veprimtarisë akademike të programit;</i> <i>Vendimi për ngritjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe raportet e saj periodike;</i> <i>Organigrama e Fakultetit dhe e departamentit përgjegjës për programin.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i> <i>Njësia bazë ka caktuar koordinatorin e programit se edhe struktura ndihmës akademike/administrative angazhohen në procesin e realizimit të praktikave mësimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e FGJH, Rregulloren e Programit të studimit, Planin mësimor, kurrikulën e programit të studimit, syllabuset e lëndëve,

	etj. Gjithashtu, informacioni mbi këtë program master është i aksesueshëm në faqen zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale të Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, Njësia e Gjuhës Turke. Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca I.5 Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së;</i> <i>Evidenca 2. Plani mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë.pdf</i> <i>Rregullore e programim mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë;</i> <u>https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-ne-mesuesi-ne-gjuhen-turke-per-arsimin-e-mesem-te-larte/</u>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të dytë "Master i Shkencave – Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe dokumentet nënligjore përkatëse, duke garantuar zbatimin e plotë të kërkesave akademike, organizative dhe administrative që lidhen me funksionimin e programit. Për realizimin e këtij programi, njësia bazë: • Organizon planin e studimit sipas strukturës modulare dhe ndarjes në lëndë të detyrueshme, me zgjedhje, praktikë profesionale dhe detyrim përmbyllës (punim diplome), në përputhje me përcaktimet e Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM). • Angazhon staf akademik me kualifikimet e nevojshme, të cilët mbulojnë lëndët bazë, karakterizuese dhe ndërdisiplinore, duke garantuar cilësinë e përmbajtjes mësimore dhe të formimit profesional të studentëve. • Siguron mbështetje të plotë nga personeli ndihmës akademik dhe administrativ, të cilët janë të përfshirë në: ○ organizimin dhe monitorimin e praktikës profesionale të studentëve në institucionet e arsimit parauniversitar; ○ ndihmën logjistike dhe dokumentare për modulet praktike apo laboratorike (kur janë të aplikueshme);



	- o koordinimin e veprimtarive të mentorimit, mbikëqyrjes dhe vlerësimit të praktikës; - o mbështetjen teknike dhe informatike për realizimin e mësimit në mjedise fizike dhe online. • Zhvillon bashkëpunime me shkolla partnere dhe institucione arsimore, të cilat shërbejnë si terren për realizimin e praktikës mësimore dhe përfshirjen e mësuesve mentorë në procesin formues të studentëve. • Siguron mbështetje institucionale për përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës, duke caktuar udhëheqës shkencorë, komisione vlerësimi dhe afate të qarta për përmbushjen e këtij detyrimi akademik. Përmes këtij organizimi dhe angazhimi të burimeve njerëzore dhe institucionale, njësia bazë garanton jo vetëm përputhjen me standardet ligjore, por edhe cilësinë dhe koherencën e formimit akademik e profesional të studentëve të programit. Evidenca <i>Evidenca 1.1 Statuti i UT-së;</i> <i>Evidenca 1.5 Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca 1.7 Rregullore e FGJH-së;</i> <i>Evidenca 2. Plani mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë.pdf</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e programim mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë.pdf</i> <i>https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-ne-mesuesi-ne-gjuhen-turke-per-arsimin-e-mesem-te-larte/</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit "Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" ofron në mënyrë të plotë dhe të qartë informacionin e nevojshëm që lidhet me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informacioni është i strukturuar në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, përfshirë Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe vendimet dhe udhëzimet përkatëse të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.

	Procedurat për pranimin e studentëve, kuotat vjetore dhe kriteret specifike publikohen rregullisht në faqet zyrtare të Universitetit të Tiranës, në portalin U-Albania, si dhe në kanalet institucionale të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, përfshirë rrjetet sociale dhe materialet informuese si fletëpalosje dhe guida studentore. Kjo siguron transparencë, qasje të lehtë dhe orientim të saktë për studentët aktualë dhe të ardhshëm. Po ashtu, janë të qarta dhe të dokumentuara procedurat për transferimin e studentëve nga institucione të tjera, si dhe për ekuivalentimin e krediteve në kuadër të mobilitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke siguruar një trajtim të barabartë dhe të standardizuar të kërkesave të studentëve. Evidenca <i>Evidenca I.5 Rregullorja e UT-së;</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së;</i> <i>Evidenca II.2 Rregullore e diplomimit e programeve të ciklit master Vendim Dekanati 22 dt 18.03.2022.pdf</i> <i>Evidenca 3. Rregullore e programim mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë.pdf</i> https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimet-kuotat-dhe-tarifat-e-studimit/
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Master i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” përmban një strukturë të qartë dhe të plotë të të gjitha komponentëve formues, në përputhje me kuadrin rregullator të MAS dhe UT. Për çdo lëndë që ofrohet në kuadër të programit, janë hartuar syllabusë në përputhje me formatin e miratuar, ku janë të përfshira: objektivat e lëndës, përshkrimi i përmbajtjes, rezultatet e të nxëniet, metodat e mësimdhënies, format e vlerësimit, si dhe bibliografia përkatëse. Gjithashtu, syllabuset përfshijnë informacion të detajuar për komponentët e praktikës profesionale, përfshirë stazhet mësimore në institucionet arsimore parauniversitare, të cilat përbëjnë një element thelbësor të formimit profesional të studentëve në këtë program. Seminarët, orët e laboratorit (kur është e aplikueshme), si dhe angazhimet jashtë auditorit janë të specifikuara qartë, si në nivelin e planifikimit të ngarkesës së studentit, ashtu edhe në përmbajtjen e mësimdhënies. Në këtë mënyrë, programi siguron një balancim të duhur ndërmjet përmbajtjes teorike dhe përvojës praktike, duke garantuar arritjen e kompetencave të kërkuara për

	profilin e mësuesit të gjuhës turke në arsimin e mesëm. Të gjithë përbërësit e programit janë të dokumentuar sipas formateve zyrtare të miratuara nga institucionet përkatëse. Evidenca <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i> <i>Evidenca 8. Tabelat e RVB në gjuhën shqipe.pdf</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik, parashikohet shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimeve eventuale që mund të lindin si rezultat i rishikimit të kurrikulës apo nevojës për rifreskimin e përmbajtjes së moduleve/lëndëve. Përditësimi i programeve lëndore (syllabuset) bazohet në dy drejtime kryesore: a) rishikime të planifikuara të kurrikulës së përgjithshme për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e studimit dhe nevojat e tregut të punës; b) përditësim i përmbajtjes dhe literaturës së secilës lëndë për të garantuar cilësi akademike dhe përputhshmëri me standardet bashkëkohore të mësimdhënies; Pas miratimit, të gjitha ndryshimet arkivohen në mënyrë të plotë në dy gjuhë – shqip dhe anglisht – duke siguruar dokumentim transparent dhe aksesueshmëri për të gjithë aktorët institucionalë dhe ndërkombëtarë. Evidenca <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i>
Konkluzione	<i>Programi paraqitet i plotë, koherent dhe i strukturuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me objektivat formues të ciklit të dytë të studimeve.</i> <i>Programi përmban të gjitha informacionet përkatëse mbi strukturën, përmbajtjen, lëndët, ndarjen sipas krediteve, si dhe komponentët formues teorikë dhe praktikë. Syllabuset janë të hartuara në përputhje me formatin zyrtar dhe ofrojnë objektiva të qarta, përmbajtje të strukturuar, metoda mësimdhënieje e vlerësimi, dhe bibliografi të përditësuar. Elementët e praktikës profesionale janë të integruar qartë dhe trajtohen si pjesë përbërëse e formimit profesional të studentit.</i>

	GVJ konstaton se ky kriter përmbushet plotësisht. sepse programi garanton cilësinë e formimit akademik dhe profesional të studentëve dhe përputhjen me objektivat e ciklit të dytë të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave, në Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë" është ndërtuar në përputhje me objektivat formues dhe me nivelin e kualifikimit të parashikuar nga Kuadri Kombëtar dhe Evropian i Kualifikimeve për ciklin e dytë të studimeve. Struktura e programit është e organizuar në 120 kredite ECTS të shpërndara në katër semestra gjatë dy viteve akademike, duke respektuar kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Shqipëri (Ligji nr. 80/2015 dhe VKM përkatëse). Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve janë të konceptuara për të ofruar një formim të integruar teorik dhe praktik. <u>Programi nuk përmban lëndë bazë</u>, por vetëm lëndë karakterizuese, ndërdisiplinore dhe integruese, të cilat ndërtohen mbi një qasje të thelluar gjuhësore, kulturore dhe pedagogjike. Ato synojnë zhvillimin e njohurive shkencore dhe profesionale në fushën e gjuhës turke dhe didaktikës së saj, si dhe përgatitjen e studentëve për përfshirjen në tregun e punës apo për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë. Komponentët mësimorë (leksione, seminare, ushtrime dhe forma të kontrollit të vazhdueshëm) janë të dizajnuara për të nxitur mendimin kritik, kreativitetin dhe ndërveprimin student-pedagog, duke përforcuar zhvillimin e kompetencave komunikuese, kërkimore dhe mësimdhënëse. Gjithashtu, programi parashikon praktika profesionale në bashkëpunim me institucione arsimore dhe organizata të tjera

	përkatëse, çka përforcon lidhjen me tregun e punës dhe përgatit studentët për integrimin aktiv në fusha të ndryshme të mësimdhënies apo për vazhdim të karrierës akademike. Në këtë mënyrë, programi arrin të përmbushë në mënyrë të kënaqshme kriterin për strukturën, përmbajtjen dhe funksionalitetin e tij në raport me objektivat formues dhe kërkesat e tregut të punës. Evidenca <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i> https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-ne-mesuesi-ne-gjuhen-turke-per-arsimin-e-mesem-te-larte/
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Struktura e programit të studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm" paraqitet e ndërtuar në përputhje me objektivat formues dhe rezultatet e pritura të të nxënit. Programi është konceptuar në dy vite akademike dhe katër semestra, me një ngarkesë totale prej 120 kreditesh ECTS, duke respektuar standardet e ciklit të dytë të studimeve sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Modularizimi i programit paraqet një ndarje të qartë të lëndëve në komponentin formues të përgjithshëm, atë të fushës së formimit profesional dhe komponentin kërkimor/shkencor. Lëndët janë të shpërndara në mënyrë të balancuar në çdo semestër, duke mundësuar progresion të qëndrueshëm dhe të ndërgjegjshëm të studentit, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik e profesional. Lëndët e ofruara mbulojnë tematika bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve të huaja dhe në veçanti të gjuhës turke, si dhe përfshijnë një përgatitje solide në fushat e pedagogjisë, metodologjisë së mësimdhënies, psikologjisë arsimore dhe teknologjive të informacionit për arsimin. Gjithashtu, përfshirja e praktikës profesionale dhe përgatitjes për tezën e diplomës në semestrin e fundit ofron mundësi për zhvillimin e kompetencave kërkimore dhe përmbushjen e objektivave shkencore të programit. Evidenca <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i> <i>Evidenca 8. Tabelat e RVB në gjuhën shqipe.pdf</i>
Kriteri 3. Struktura e	Bazuar në dokumentacion e ofruar nga institucioni por edhe gjatë

programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	vizitës dhe takimeve në institucion, GVJ-ja konstaton se struktura e programit të studimit është organizuar në përputhje me profilin e programit dhe synon formimin e specialistëve në fushën e mësuesisë së gjuhës turke për arsimin e mesëm të lartë. Gjithashtu, struktura e programit, lëndët dhe raporti teori-praktikë janë orientuar nga programe të ngjashme, gjë që ka krijuar mundësinë e shkëmbimit si për stafin dhe studentët, si dhe njohjen e periudhës së studimit në universitete të huaja. Evidenca <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i> <i>Evidenca II.1, Rregullore e programit të studimit, neni 8-9;</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm konstaton se ndarja e veprimtarive formuese midis formimit teorik dhe praktik në programin e studimit është e qartë dhe e balancuar. Kjo ndarje mundëson arritjen e objektivave formues të programit duke siguruar një kuadër të plotë dhe të integruar të njohurive dhe aftësive të nevojshme për studentët. <i>Megjithatë siç është komentuar edhe në standardet më lart, ka një mospërputhje të ndarjes së veprimtarive formuese në kategoritë A-E sipas përqindjes dhe ECTS-ve në planin mësimor dhe të veprimtarive formuese sipas VKM 41, 24.01.2018.</i> Përveç kësaj, struktura e programit favorizon transferimin e krediteve dhe krijon mundësi për mobilitet studentor, siç evidentohet nga bashkëpunimet ndërinstitucionale dhe pjesëmarrja aktive e studentëve në programin Erasmus+ në universitete partnere në Turqi dhe Bullgari. Kjo rrit cilësinë e formimit dhe perspektivat e punësimit të diplomantëve, duke i përgatitur ata për sfidat e tregut të punës dhe për angazhime akademike të mëtejshme. Evidenca <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i> <i>Evidenca 8. Tabelat e RVB në gjuhën shqipe.pdf</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në	Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm (GVJ) vlerëson se syllabuset e programit Master i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” përditësohen në mënyrë të



mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	vazhdueshme dhe sistematike, duke marrë parasysh dy nevoja thelbësore: rishikimin e kurrikulës dhe përditësimin e përmbajtjes dhe literaturës së modulëve/lëndëve. Ky proces i përditësimit siguron që programi të jetë në përputhje me kërkesat bashkëkohore të fushës dhe të tregut të punës. Gjithashtu, silabuset përgatiten në përputhje me rregulloret kombëtare (VKM nr. 241, dt. 24.01.2018), duke përfshirë elementet e domosdoshme të literaturës bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. Kjo qasje përmirëson cilësinë e përmbajtjes së mësimin dhe ndihmon studentët që të marrin kompetencat profesionale të nevojshme, të cilat janë të përshtatura me kërkesat reale të tregut të punës dhe zhvillimet shkencore në fushën e gjuhës turke dhe arsimit. Për pasojë, GVJ vlerëson se përditësimi i vazhdueshëm i syllabuseve është një element kyç që kontribuon në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe përgatitjen e studentëve për punësim dhe zhvillim profesional. Evidenca <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm (GVJ) vlerëson se përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm” është e strukturuar në mënyrë që të sigurojë përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Kurrikula është e bazuar qartë në kompetenca të përcaktuara, ku çdo lëndë kontribuon në arritjen e këtyre kompetencave përmes përmbajtjes së saj dhe rezultateve të pritura të të nxëniet. Programi adreson në mënyrë të plotë kompetencat bazë gjuhësore, profesionale dhe ato të fushës, duke garantuar një formim të gjithanshëm dhe të thelluar për studentët e ciklit të dytë. Në këtë mënyrë, programi i ofron studentëve një kuadër të qartë dhe të mirëstrukturuar që siguron zhvillimin e aftësive të nevojshme për suksesin në karrierën e tyre arsimore dhe profesionale. <i>Ndërkohë që GVJ konstaton se literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar në disa nga syllabuset mund të konsiderohet e vjetërsuar dhe e mbi dhjetë viteve të fundit.</i> <u><i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës me botime të pesë viteve të fundit.</i></u>



Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ-ja konstaton se bazuar në dokumentacionin e paraqitur, studentët që diplomohen në këtë program studimi, referuar përmbajtjes së tij, janë në gjendje të vijnë studimet e mëtejshme në programe të ciklit të tretë. Gjithashtu programi mundëson pajisjen e studentëve me aftësi që i bën të përshtatshëm dhe konkurrues në tregin e punës dhe kërkesat e tij. Më konkretisht, përmes nxitjes për pjesëmarrje në konferenca, lëndës së kërkimit shkencor dhe përgatitjes së punimit të diplomës, studentët përgatiten për vijimin e studimeve të ciklit të tretë. Për sa i përket punësimit, krahas lëndëve që mundësojnë aftësimin praktik të studentëve si përkthyes, zhvillimi i praktikës profesionale në agjenci përkthimi dhe organizata të ndryshme i njeh studentët më nga afër me nevojat e tregut të punës dhe i përgatit për to. Ky është i vetmi program që arrin të punësojë në masën 100% të diplomuarit sepse kërkesat e tregut për këtë gjuhë sot janë shtuar jo vetëm në fushën e mësuesisë por dhe në fushën e përkthimeve legale, dokumentarësh, filmash, romanesh apo dhe në konferenca dhe profesione të lira. Evidenca https://fgjh.edu.al/master-i-shkencave-ne-mesuesi-ne-gjuhen-turke-per-arsimin-e-mesem-te-larte/ <i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i> <i>Evidenca II.1 Plani mësimor</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit është ndërtuar në përputhje të plotë me objektivat formuese, kornizat kombëtare dhe europiane të kualifikimeve, duke siguruar një strukturë të organizuar në 120 kredite ECTS, të shpërndara në katër semestra për dy vite. Kjo strukturë garanton një ngarkesë të balancuar dhe progresion të qëndrueshëm të studentëve në aspektin teorik, praktik dhe kërkimor. Programi nxit zhvillimin e kompetencave të nevojshme për tregun e punës dhe vazhdimin e studimeve të avancuara, duke përfshirë edhe praktikën profesionale dhe punën kërkimore për tezën e diplomës.</i> <i>Gjithashtu, syllabuset përditësohen në mënyrë sistematike, duke siguruar përmbajtje bashkëkohore dhe literaturë të përshtatshme, në përputhje me standardet ligjore dhe kërkesat e fushës.</i> <i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës me botime të viteve të</i>



	fundit për një pjesë të mire të syllabuseve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Bazuar në dokumentacionin dhe aktivitetet e paraqitura, konstatohet se njësitë përgjegjëse të institucionit kanë ndjekur me seriozitet procesin e përmirësimit dhe përshtatjes së përmbajtjes së programit të studimit me kërkesat reale të tregut të punës. Organizimi i ëorkshop-it me temë "Studentët dhe tregu i punës", më datë 18.12.2019, ku janë përfshirë përfaqësues nga Drejtoria e Edukimit, Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, fakultetet përkatëse, si dhe aktorë të jashtëm të tregut të punës (biznese, institucione publike, punëdhënës kryesorë të studentëve të UT-së), dëshmon një qasje të mirëfilltë dhe të strukturuar për përfshirjen e partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Për më tepër, konsultimi i institucioneve partnere, i diplomuarve dhe i aktorëve të tjerë nga tregu i punës është një praktikë që tregon përkushtim ndaj përputhshmërisë së programit me nevojat reale profesionale, duke rritur kështu mundësitë e punësimit të studentëve. Kjo praktikë përputhet mirë me kërkesat e Standardit II.5, i cili kërkon përfshirjen aktive të studentëve, partnerëve dhe organizmave të ndryshëm në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, për të garantuar realizimin e objektivave të tyre në përputhje me tregun dhe shoqërinë. <i>GVJ sugjeron: Për të përmirësuar më tej këtë proces, rekomandohet që dokumentacioni i këtyre konsultimeve dhe propozimeve të integrohet sistematikisht në hartimin formal të programeve, dhe të ruhet si dëshmi për auditime të mëtejshme.</i> Evidenca

	<i>Evidenca I.14 Statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca II.8. Manuali i Cilësisë,</i> <i>Evidenca II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë,</i> <i>Evidenca II.22 Strategjia për sigurimin e cilësisë 2022-2024,</i> <i>Evidenca V.20 Studimi i tregut te punes.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni ka ndërmarrë hapa të qarta dhe të dokumentuara për të nxitur dhe përfshirë studentët dhe strukturat e tyre përfaqësuese në diskutimet që lidhen me përmirësimin e programeve të studimit. Evidencat e ofruara tregojnë për një angazhim të vazhdueshëm në mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar dhe përfshirjen e tyre në proceset reflektuese mbi cilësinë dhe përmbajtjen e studimeve. Gjithashtu, institucionet dhe organizatat bashkëpunuese, të cilat përfshijnë institucione shtetërore, organizata profesionale dhe përfaqësues të tregut të punës, janë pjesë e procesit të bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave mësimore. Këto marrëveshje të formalizuara, të shoqëruara me manualin për praktikën profesionale, përforcojnë ndërlidhjen e vazhdueshme midis institucionit dhe studentëve, duke i ofruar këtyre të fundit mundësi konkrete për të reflektuar mbi programin dhe për të ndikuar në përmirësimin e tij përmes eksperiencës së drejtpërdrejtë në fushën përkatëse. Mekanizmat formalë, si kërkesat zyrtare për bashkëpunim të përcjella nga dekanët dhe rektorati për zhvillimin e praktikave të ciklit të dytë të studimeve, tregojnë një strukturë të institucionalizuar për përfshirjen e studentëve dhe përfitimin nga reflektimet e tyre pasdiplomimit. Bazuar në këto elemente, GVJ vlerëson se institucioni ka vendosur një bazë të qëndrueshme për përfshirjen e studentëve dhe të diplomuarve në diskutime që ndikojnë në përmirësimin e programeve të studimit. <u>Rekomandim:</u> GVJ sugjeron që ky bashkëpunim dhe përfshirje të sistematizohet më tej përmes mekanizmave të rregullt të mbledhjes së feedback-ut nga Alumni (p.sh. sondazhe vjetore) dhe përmes përfshirjes së përfaqësuesve të studentëve në strukturat vendimmarrëse të njësive përgjegjëse për programet.
	Evidenca <i>Evidenca I.9 Raporti Vjetor kërkimor-shkencor 2021-2022,</i> <i>Evidenca I.10 Raporti vjetor kërkimor –shkencor 2022-2023.</i>

Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Nga evidencat e paraqitura rezulton se njësia përgjegjëse për programin e studimit është e angazhuar në mënyrë të strukturuar për të përmirësuar, përditësuar dhe përshtatur programin në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse. Kjo realizohet përmes bashkëpunimit me institucione publike dhe private, ku evidentohen marrëveshje konkrete bashkëpunimi, si dhe manuali i praktikës profesionale, që udhëzon dhe standardizon realizimin e komponentëve praktikë të programit. Programi i praktikës hartohet posaçërisht dhe përfshin përfshirjen e pedagogëve mbikëqyrës, gjë që tregon angazhim të drejtpërdrejtë të stafit akademik në ndjekjen e aplikimit të njohurive teorike në mjedise profesionale. Për më tepër, dokumentacioni i praktikës përfshin marrëveshjet me institucionet pritëse, listat emërore të studentëve, vërtetimet nga fakulteti si dhe formularët e vlerësimit nga institucionet partnere, çka dëshmon për një proces të mbikëqyrur dhe të dokumentuar. Evidenca <i>Evidenca Shenime UT, FGJH.pdf</i> <i>Evidenca I. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca I.1 statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH,</i> <i>Evidenca III.2 Tabela 13 ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies,</i> <i>Evidenca 3. Rregulloje e programim mësimor Master Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesë të lartë.pdf</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ka ndërmarrë veprime të strukturuar dhe të dokumentuara për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, e studentëve dhe e të diplomuarve në reflektimet mbi programin dëshmon për një angazhim të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar në këtë drejtim. Gjithashtu, proceset e formalizuara për realizimin e praktikave profesionale dhe bashkëpunimi me institucione të ndryshme mbështesin aplikimin praktik të njohurive teorike.</i> <u><i>Rekomandohet që përmirësimi i mëtejshëm të fokusohet në sistematizimin e mekanizmave të mbledhjes së feedback-ut nga Alumni dhe zgjerimin e bashkëpunimeve me rrjete profesionistësh</i></u>

	<i>dhe organizata të fushës përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” përmbush në mënyrë të qartë kërkesat e këtij kriteri. Dokumentacioni përkatës (RVB dhe syllabuset e lëndëve) dëshmon se programi përcakton qartë objektivat kryesorë dhe prioritetet në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Objektivat e përgjithshëm të programit janë të orientuar drejt formimit të kompetencave të avancuara gjuhësore dhe profesionale për mësimdhënie në gjuhën turke, si dhe përgatitjes së studentëve për angazhim në kërkimin shkencor në këtë fushë. Struktura e programit dhe përmbajtja e lëndëve janë të harmonizuara me objektivat madhorë të institucionit, duke synuar jo vetëm zhvillimin e aftësive praktike në arsim, por edhe formimin e një baze të qëndrueshme për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë. Lëndët mbështeten në literaturë bashkëkohore, e cila përditësohet, dhe secila prej tyre kontribuon në realizimin e objektiveve të përgjithshme përmes rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të aftësive përkatëse. Gjithashtu, ekzistenca e një programi doktorature në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në të cilin programi master lidhet organikisht përmes Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, tregon për një qasje të integruar ndaj studimit dhe kërkimit shkencor. Kjo qasje siguron një vazhdimësi akademike dhe kërkimore për studentët e ciklit të dytë. Evidenca <i>Evidenca Shenime UT, FGJH.pdf</i> <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i>

	<i>Evidenca 14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe të dhënave në tekstin e RVB-së, rezulton se njësia bazë (Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike) përmbush në mënyrë të qartë dhe të plotë kërkesat e këtij kriteri. Ajo luan një rol aktiv në nxitjen, koordinimin dhe administrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me lirinë akademike të stafit dhe natyrën e veçantë të fushës së studimit. Personeli akademik me kohë të plotë është angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në aktivitete shkencore dhe akademike si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke përfaqësuar programin në universitete të njohura të Turqisë, si dhe në vende të tjera të rajonit ose më gjerë si Kosova, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Gjermania, Franca, SHBA dhe Azerbajxhani. Ky pjesëmarrje e gjerë tregon për një ndërkombëtarizim të shënuar të veprimtarisë kërkimore dhe për një mbështetje të fortë nga njësia përkatëse. Për më tepër, përfshirja e personelit akademik në programin Erasmus+ si për mobilitetin e stafit, ashtu edhe për shoqërimin dhe shkëmbimin e studentëve me universitete të huaja, dëshmon për një kulturë akademike të hapur, bashkëpunuese dhe dinamike. Gjithashtu, bashkëpunimi me institucione turke në Tiranë dhe përfshirja në atelie për përkthim letrar në Stamboll, si dhe vlerësimet nga institucione ndërkombëtare, tregojnë për një veprimtari të pasur dhe të njohur profesionalisht dhe shkencërisht. Përkthimet e realizuara nga pedagogët e gjuhës turke, si dhe vlerësimi i tyre nga Ministria e Kulturës në Shqipëri, e pasurojnë më tej kontributin akademik dhe artistik të stafit, duke dëshmuar jo vetëm përkushtim ndaj mësimdhënies, por edhe një angazhim të mirëfilltë në fushën e kërkimit dhe përhapjes së dijes kulturore dhe gjuhësore. Evidenca <i>Evidenca Shenime UT, FGJH.pdf</i> <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 10. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit ne kuadër të Erasmus+.pdf</i> <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i>
Kriteri 3. Programi i	Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur në RVB dhe e të

studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	dhënave mbështetëse, rezulton se programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Gjuhën Turke në Arsimin e Mesëm të Lartë” përmbush në mënyrë të plotë dhe të dukshme kërkesat e këtij kriteri. Studentët janë të angazhuar në një sërë aktivitete kërkimore dhe akademike që zhvillohen në kuadër të programit, si pjesëmarrja në konferenca kombëtare e ndërkombëtare (si ajo e Universitetit Baskent në Ankara dhe ajo për studiues të rinj në Bodrum e organizuar nga TIKA dhe TÜBİTAK), si dhe përfshirja në mobilitete ndërkombëtare përmes programit Erasmus+, çka dëshmon se programi i motivon dhe i mbështet studentët në përfshirjen në jetën akademike dhe kërkimore. Gjithashtu, vlerësohet fakti që një studente e diplomuar nga cikli i parë i studimeve në gjuhën turke ka përfituar bursë për studime të mëtejshme master në Universitetin Hacettepe, duke dëshmuar për përgatitjen cilësore që programi ofron, si dhe për mundësitë reale që ai krijon për zhvillimin akademik të studentëve. Këto të dhëna tregojnë për një frymë aktive të nxitjes dhe përfshirjes së studentëve në veprimtari kërkimore dhe në eksperiencat të ndërkombëtarizimit, në përputhje me objektivat e programit dhe misionin e institucionit. Evidenca <i>Evidenca Shenime UT, FGJH.pdf</i> <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 10. Të dhëna mbi mobilitetin e stafit në kuadër të Erasmus+.pdf</i> <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në RVB, vërehet se njësia bazë, në këtë rast Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike, ku përfshihet edhe programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme në funksion të qëllimeve të saj akademike, kërkimore dhe zhvillimore.
	Institucioni harton çdo fillim viti raportin financiar si pjesë e raportit vjetor të Fakultetit, ku përfshihen të dhëna të detajuara mbi kostot, të ardhurat, tarifat e shkollimit dhe koston mesatare



	për student. Po ashtu, institucioni ndjek nga afër ecurinë e programeve të studimit, përfshirë edhe programin në fjalë, çka tregon për një administrim të qëndrueshëm financiar dhe një përkushtim ndaj zhvillimit të programeve akademike. Gjithashtu, evidencat tregojnë se në kuadër të Departamentit funksionojnë dy grupe mësimor-kërkimore, ku për programin në gjuhën turke është aktiv Grupi Mësimor-Kërkimor “Gjuhësi – Didaktika e Gjuhës Turke”, i cili angazhohet në: • aktivitete studimore dhe kërkimore; • pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare; • organizim ëorkshop-esh dhe leksionesh të hapura me profesorë nga Turqia; • projekte për doktoratura në fushën e gjuhësisë, didaktikës dhe përkthimit; Këto aktivitete janë të mbështetura nga fondet institucionale dhe të ardhurat e gjeneruara nga vetë njësia, duke dëshmuar për një strukturë funksionale dhe të mirëorganizuar të mbështetjes financiare për veprimtarinë kërkimore-shkencore. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 11. Lista e konferencave, trajnimeve dhe Ëorkshopeve.pdf</i> <i>Evidenca 12. Konferenca studentore.pdf</i> <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i> <i>Evidenca 6. Raport Vjetor për Sigurimin e Cilësisë.pdf</i>
Konkluzione	<i>Programi është i strukturuar qartë në përputhje me objektivat institucionale dhe orientimin akademik e kërkimor, duke garantuar zhvillimin e kompetencave profesionale dhe të avancuara në fushën e mësimdhënies në gjuhën turke.</i> <i>Njësia bazë përgjegjëse (Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike) luan një rol aktiv në organizimin dhe mbështetjen e veprimtarive akademike dhe kërkimore, ndërkohë që siguron një mjedis të hapur dhe ndërkombëtar bashkëpunimi përmes mobiliteteve, përfshirjes në projekte dhe bashkëpunimeve me institucione të huaja.</i> <i>Gjithashtu, dokumentacioni dëshmon për një angazhim të</i>

	<i>qëndrueshëm institucional në mbështetjen financiare dhe organizative të aktiviteteve shkencore, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillimin profesional të stafit akademik dhe për përfshirjen aktive të studentëve në jetën akademike e kërkimore.</i> <i>Në përfundim, programi demonstroi një përputhje të plotë me kërkesat e standardit në aspektin e planifikimit, realizimit dhe mbështetjes së veprimtarive mësimore e kërkimore, duke u vlerësuar si një model i mirë funksionimi dhe zhvillimi akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse e programit të studimit demonstroi angazhim të qëndrueshëm në mbështetjen e grupeve lëndore dhe të projekteve kërkimore-shkencore të reja, duke krijuar një mjedis nxitës për zhvillimin e kërkimit bashkëkohor dhe për përmbushjen e objektivave akademike. Kjo mbështetje përfshin ofrimin e kushteve institucionale dhe organizative që lehtësojnë formimin e grupeve kërkimore, nxitjen e bashkëpunimeve të brendshme dhe ndërinstitucionale, si dhe përfshirjen aktive të personelit akademik në projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përfshirja e personelit akademik në programe dhe projekte kërkimore të financuara nga institucione publike dhe private, si dhe nga organizata ndërkombëtare, është dëshmi e qartë e funksionimit të mirë të kësaj njësie. Kjo ka sjellë rritje të cilësisë në aktivitetin kërkimor dhe ka ndikuar pozitivisht në procesin mësimor, duke integruar rezultatet e kërkimeve në përmbajtjet e programeve të studimit dhe duke pasuruar përvojën akademike të studentëve. Gjithashtu, njësia përgjegjëse ka zhvilluar forma të ndryshme bashkëpunimi me struktura të tjera kërkimore-shkencore, brenda dhe jashtë njësisë bazë, çka reflekton një qasje bashkëkohore dhe të hapur ndaj ndërveprimit institucional në

	kërkimin shkencor. Këto bashkëpunime kanë mundësuar ndarjen e burimeve, ideve dhe praktikave të mira, duke përforcuar ndërkombëtarizimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 11. Lista e konferencave, trajnimeve dhe Ëorkshopeve.pdf</i> <i>Evidenca 12. Konferenca studentore.pdf</i> <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i> <i>Evidenca 6. Raport Vjetor për Sigurimin e Cilësisë.pdf</i> <i>Evidencë V.18 26.12.2023 Per miratimin e raportit te veprimtarise mesimore,kerkimore shkencore dhe financiare te UT,2022-2023.pdf</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia përgjegjëse e programit të studimit në Gjuhën Turke dëshmon një përkushtim të qartë për të reaguar ndaj kërkesave në rritje për analiza, studime dhe projekte me karakter kërkimor-shkencor. Siç theksohet në dokumentacionin e RVB-së, Dega e Gjuhës Turke është angazhuar në mënyrë të strukturuar në identifikimin dhe përmbushjen e këtyre kërkesave, duke kontribuar aktivisht në ndërtimin e një kulture kërkimore të qëndrueshme në kuadër të institucionit. Njësia jo vetëm që mbështet përfshirjen e personelit akademik në projekte studimore dhe kërkimore, por edhe krijon mekanizma konkrete për të përfshirë studentët në këto procese. Kjo vihet re sidomos në kuadër të programit të doktoraturës, ku pedagogët udhëheqës dhe studentët që kanë përfunduar programin “Master i Shkencave – Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” janë të angazhuar në aktivitete kërkimore të cilat ndihmojnë në realizimin e objektivave të programit dhe në konsolidimin e formimit të tyre akademik. Ky bashkëpunim ndërmjet stafit akademik dhe studentëve promovon një qasje të integruar në kërkimin shkencor, si dhe siguron vazhdimësinë midis cikleve të studimit, veçanërisht në raportin midis programeve të masterit dhe doktoraturës. Përfshirja e studentëve në projektet kërkimore ndihmon jo vetëm në rritjen e kompetencave të tyre shkencore, por edhe në zhvillimin e aftësive analitike dhe profesionale që kërkohen në tregun akademik dhe arsimor.

	Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 11. Lista e konferencave, trajnimeve dhe Ëorkshopeve.pdf</i> <i>Evidenca 12. Konferenca studentore.pdf</i> <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i> <i>Evidenca 6. Raport Vjetor për Sigurimin e Cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 13. Analizë vjetor për Kërkimin shkencor.pdf</i> <i>Evidencë III.41_ Konferenca shkencore me Universitetin Ionina te Korfuzit.pdf</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Në përputhje me objektivat e programit të studimit, njësia përgjegjëse ka dëshmuar një angazhim të qëndrueshëm dhe të mirëorganizuar në zhvillimin e konferencave dhe aktiviteteve të ndryshme shkencore dhe akademike, të cilat kontribuojnë në formimin e vazhdueshëm të personelit akademik dhe studentëve. Këto iniciativa kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimit shkencor në fushën e gjuhës turke. Shembuj konkretë që dëshmojnë përmbushjen e këtij kriteri përfshijnë: • Organizimin e takimeve shkencore në kuadër të 100-vjetorit të themelimit të Republikës së Turqisë dhe 100-vjetorit të marrëdhënieve shtetërore Shqipëri-Turqi, duke krijuar një kontekst historik dhe kulturor të pasur për reflektim akademik; • Kurset online të mësimi të gjuhës turke të ofruara nga Universiteti i Bilkentit, të strukturuar sipas niveleve të Kuadrit Evropian të Referencës për Gjuhët, kanë ndihmuar në përvetësimin e standardizuar të gjuhës nga studentët dhe janë shoqëruar me pajisje me certifikata; • Organizimi i ëorkshop-eve me tema të ndryshme gjuhësore dhe shkolla verore për paleografinë dhe kaligrafinë e gjuhës turke kanë ofruar hapësira të specializuara për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe praktike të studentëve; • Kontributi në organizimin e kongresit ndërkombëtar të studimeve rajonale “Gjuha Turke në Arcalin Ballkanik”, si dhe aktivitete të tjera në kuadër të Ditës Botërore të Gjuhës Turke, dëshmon për përfshirjen aktive të njësisë në rrjete kërkimore dhe shkëmbime akademike



	ndërkombëtare; Këto aktivitete janë në përputhje të plotë me objektivat e programit të studimit dhe ndikojnë në rritjen e ndërkombëtarizimit, përf forcimin e identitetit akademik të njësisë, si dhe në përfshirjen aktive të studentëve në jetën akademike dhe kërkimore të institucionit. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 11. Lista e konferencave, trajnimeve dhe Ëorkshopeve.pdf</i> <i>Evidenca 12. Konferenca studentore.pdf</i> <i>Evidenca 15. Raport për kërkimin Shkencor.pdf</i> <i>Evidenca 6. Raport Vjetor për Sigurimin e Cilësisë.pdf</i> <i>Evidenca 13. Analizë vjetor për Kërkimin shkencor.pdf</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	U konstatua se grupi Mësimor Kërkimor Gjuhësi - Didaktikë e Gjuhës Turke tregon një përkushtim të fortë ndaj zhvillimit të aktiviteteve mësimore dhe shkencore me fokus të qartë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nga pedagogët, bashkëpunimin e ngushtë me studentët dhe përcjelljen e zhvillimeve të fundit në fushën e shkencës, arsimit dhe tregut të punës. Kjo qasje është e rëndësishme për përshtatjen e programeve me nevojat aktuale dhe kërkesat e tregut, duke garantuar që studentët të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të qenë konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Programi i studimit Masteri i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, i cili ofrohet ekskluzivisht në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, është konceptuar në mënyrë që të formojë profesionistë të specializuar dhe të aftë për tregun e punës. Një tregues konkret i suksesit të këtij programi është fakti se studentët e diplomuar prej tij janë punësuar në institucione arsimore, si vendase ashtu edhe turke, që zhvillojnë aktivitete në territorin shqiptar. Kjo dëshmon për përshtatjen e programeve me nevojat reale të tregut të punës dhe për aftësinë e studentëve për të integruar me sukses në fushën profesionale. Gjithashtu, strategjia e ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja kontribuon në rritjen e vizibilitetit dhe reputacionit ndërkombëtar të programit dhe njësisë përgjegjëse, duke zgjeruar kështu

	mundësitë e karrierës për studentët në nivel global. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca 1.2 Statuti i UT-së</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i> <i>Evidenca 1.19 Memorandume bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale,</i> <i>Evidenca II.29 Dosje e praktikës së studentit,</i> <i>Evidenca Tabelat.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Njësia përgjegjëse tregon një angazhim të qartë dhe të vazhdueshëm për respektimin dhe zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale dhe rrjetet profesionale, që lidhen me kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës. Kjo është një praktikë thelbësore për sigurimin e përshtatshmërisë së programit të studimit me kërkesat ligjore dhe profesionale në fushën e arsimit dhe mësimdhënies në gjuhën turke. Në këtë kuadër, studentët e diplomuar në programin “Master i Shkencave – Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë” shprehin interes konkret për procesin e marrjes së licencës profesionale, në përputhje me akte ligjore në fuqi, që siguron aftësimin e tyre ligjor dhe profesional për ushtrimin e detyrës. Gjithashtu, personeli akademik i njësisë angazhohet në trajnimet e ndryshme të organizuara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, duke e përmirësuar vazhdimisht kualifikimin e tyre dhe duke ndjekur zhvillimet më të fundit në fushën profesionale, gjë që kontribuon në mbajtjen dhe përmirësimin e standardeve të programit. Evidenca <i>Evidenca II.17 Studim i Tregut të Punës-.pdf</i> <i>Evidencë 1.19 Memorandume Bashkëpunimi për Praktikën Mësimore dhe Profesionale.pdf</i> <i>Evidencë 1.17_Vendim nr.48 për Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit.pdf</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e	Programi i studimit i ofruar nga njësia përgjegjëse për profesionet e rregulluara është në përputhje me aktet ligjore në vend dhe me

rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	rekomandimet ndërkombëtare, në veçanti me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian, siç është Direktivë për Kualifikimet Profesionale (Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU). Kjo përputhshmëri siguron që programi i studimit të jetë i harmonizuar me standardet më të larta ndërkombëtare dhe të ofrojë kualifikime të njohura dhe të pranueshme jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në kuadrin evropian. Përputhshmëria me këto kërkesa ligjore dhe rekomandime ndërkombëtare reflektohet në strukturën e programit, përmbajtjen e tij dhe në proceset e mësimdhënies dhe vlerësimit, duke garantuar kështu që studentët e diplomuar janë të pajisur me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të ushtruar profesionin në përputhje me standardet europiane.			
Konkluzione	<i>Njësia përgjegjëse e programit të studimit tregon një angazhim të qëndrueshëm dhe të strukturuar në mbështetjen e kërimit shkencor, zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe formimin profesional të studentëve.</i> <i>Ajo siguron kushtet institucionale dhe organizative për nxitjen e bashkëpunimeve kërkimore, përfshirjen aktive të stafit dhe studentëve në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe organizon iniciativa shkencore që pasurojnë përvojën akademike dhe promovojnë ndërkombëtarizimin.</i> <i>Përveç kësaj, programi përgjegjës përgatit profesionistë të aftë dhe të adaptuar me kërkesat e tregut të punës dhe rregulloret ligjore për licencimin profesional, duke garantuar kështu cilësi të lartë në procesin mësimor dhe në zhvillimin e karrierës akademike dhe profesionale të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe në përshkrimin e praktikave mësimore në programin e studimit, konstatohet se formate të ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë të pranishme dhe të mirëstrukturuara. Programi zbaton një shumësi formash mësimore, përfshirë leksione, seminare, ushtrime praktike, detyra kursi dhe projekte, praktikë profesionale, laborator përktimi dhe orë të hapura me lektorë të ftuar, duke siguruar një qasje të larmishme dhe gjithëpërfshirëse në procesin akademik. Këto forma janë të dokumentuara në planet mësimore, syllabuset e lëndëve dhe rregulloret përkatëse, dhe mbështeten në një strukturë të përcaktuar të ngarkesës studentore, ku një kredi barazohet me 25 orë punë, duke përfshirë si orët në auditor, ashtu edhe punën individuale. Për më tepër, mësimdhënia dhe mësimnxënja janë të rregulluara në mënyrë të detajuar në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit dhe të Programit të Studimit, duke garantuar koherencë dhe standardizim institucional. Në këtë kontekst, vlerësohet se institucioni përmbush plotësisht kërkesat e Kriterit III.1, duke aplikuar forma bashkëkohore dhe të miratuara të mësimdhënies, me një qasje të orientuar drejt studentit dhe në funksion të zhvillimit profesional dhe shkencor të tij. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca Shenime UT, FGJH.pdf</i> <i>Evidenca I.1 statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH,</i> <i>Evidenca Programet e turqishtes _SKM_C257i24112012450.pdf</i>

	<i>Evidenca Tabelat.pdf</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Bazuar në dokumentacionin e ofruar dhe në përshkrimin e praktikave mësimore në programin e studimit, konstatohet se formate të ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë të pranishme dhe të mirëstrukturuara. Programi zbaton një shumësi formash mësimore, përfshirë leksione, seminare, ushtrime praktike, detyra kursi dhe projekte, praktikë profesionale, laborator përkthimi dhe orë të hapura me lektorë të ftuar, duke siguruar një qasje të larmishme dhe gjithëpërfshirëse në procesin akademik. Këto forma janë të dokumentuara në planet mësimore, syllabuset e lëndëve dhe rregulloret përkatëse, dhe mbështeten në një strukturë të përcaktuar të ngarkesës studentore, ku një kredi barazohet me 25 orë punë, duke përfshirë si orët në auditor, ashtu edhe punën individuale. Për më tepër, mësimdhënia dhe mësimnxënja janë të rregulluara në mënyrë të detajuar në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit dhe të Programit të Studimit, duke garantuar koherencë dhe standardizim institucional. Evidenca <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca Shenime UT, FGJH.pdf</i> <i>Evidenca I.1 statuti i UT-së,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH,</i> <i>Evidenca Programet e turqishtes _SKM_C257i24112012450.pdf</i> <i>Evidenca Tabelat.pdf</i> <i>Evidencë III.11 Shkresa e rektorit Nr.Prot 2615, 15.09.2020 Mbi platformen Microsoft Teams for Education.PDF</i> <i>Evidencë III.15 Klasa Teams "Technology Trainings for FGJH".pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Bazuar në informacionin e paraqitur në tekstin e RVB-së dhe evidencat shoqëruese, konstatohet se: Institucioni mbështet personelin akademik <u>Mbështetje në aspektin didaktik dhe teknologjik:</u> UT mbështet personelin akademik si në përmirësimin e kompetencave didaktike ashtu edhe në aspektin teknologjik që

	lehtëson procesin mësimor, duke përmendur konkretisht përputhjen e metodave të mësimdhënies me objektivat e programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Infrastrukturë moderne dhe mbështetje konkrete: Janë krijuar një sërë hapësirash të dedikuara për përmirësimin e procesit mësimor dhe trajnimin e stafit: - o Laboratori i Fonetikës; - o Laboratori i Kërkimit Shkencor dhe i Integritit; të Teknologjive në Mësimdhënie; - o Qendra Multifunksionale dhe e Trajnimeve të FGJH; Këto ambiente janë të pajisura me infrastrukturë të nevojshme për trajnime dhe zhvillim profesional të stafit akademik. Pajisje moderne në auditore: Vendosija e 11 tabelave interaktive në klasa është një tregues konkret i përpjekjes për modernizimin e mësimdhënies dhe lehtësimin e përdorimit të metodave bashkëkohore. Përputhja me strategjinë institucionale: Teksti përmend se të gjitha këto zhvillime janë pjesë e një strategjie të mirëmenduar të Fakultetit për modernizimin e mësimdhënies në përputhje me zhvillimet bashkëkohore, gjë që tregon për një vizion të qëndrueshëm institucional. Evidenca <i>Evidenca I. Statuti i UT,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca I.7 Vendim për ngritjen e Qendrës Virtuale për trajnim dhe zhvillim profesional,</i> <i>Evidenca III.12 Trajnime UT,</i> <i>Evidenca III.13 Afishe: Java e teknologjisë,</i> <i>Evidenca III.14 Email njoftues për trajnim,</i> <i>Evidenca III.15 Klasa TEAMS- Technology training for FGJH.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies	<u>Përbërja dhe kompetenca e stafit akademik:</u> Stafi akademik është me kohë të plotë dhe përfshin specialistë të fushave të gjuhësisë, letërsisë, përkthimit dhe didaktikës, me tituj dhe grada shkencore si dhe formim profesional në Shqipëri dhe jashtë saj. Evidencat e përfshira si CV-të e stafit akademik dhe plani mësimor përforcojnë pohimin mbi kompetencën

interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	përkatëse për modulet që mbulojnë. <u>Përdorimi i metodave interaktive:</u> Në RVB-në dhe evidencat përkatëse shpjegohet qartë se në zhvillimin e orës mësimore synohet interaktiviteti dhe nxitja e mendimit kritik te studentët, për ta bërë procesin më tërheqës dhe më efektiv. <u>Metoda të orientuara nga studenti:</u> Përdorimi i ushtrimeve dhe situatave studimore të ndryshme është në funksion të natyrës së lëndëve dhe objektivave të programit, çka mbështet kërkesën për nxitjen e autonomisë, përgjegjshmërisë dhe mendimit krijues. <u>Mbështetje për studentin dhe ndërtim marrëdhëniesh respekti:</u> Përfshirja e studentëve në trajnime dhe përditësime profesionale (vendase dhe të huaja), si dhe monitorimi i brendshëm i cilësisë së mësimdhënies, dëshmon për një kujdes të qëndrueshëm institucional në funksion të ndërtimit të marrëdhënieve të shëndosha dhe respektuese ndërmjet stafit dhe studentëve. Evidenca: <i>CV_Adriatik Derjaj.pdf</i> <i>CV_Alban Foçi.pdf</i> <i>CV_Spartak Kadiu.pdf</i> <i>CV_Urtis Harri.pdf</i> <i>CV_Xhemile Abdiu.pdf</i> <i>Evidenca 1. RVB, Pikat e dobta dhe të forta, Evidencat përkatëse.pdf</i> <i>Evidenca Programet e turqishtes_SKM_C257i24112012450.pdf</i> <i>Evidenca Tabelat.pdf</i> <i>14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i> <i>13. Analizë vjetor për Kërkimin shkencor.pdf</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe	Bazuar në evidencat e ngarkuara në sistem, shënimet e mbajtura gjetë vizitës dhe përmbajtjes së RVB-së vlerësojmë se plotësohen të gjitha elementet thelbësore të këtij kriteri me këto argumente: 1. Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të mësimdhënies:



duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	- o Studentët janë të përfaqësuar në organet dhe strukturat institucionale të UT-së dhe japin kontribut përmes pjesëmarrjes së tyre; - o Përdoren pyetësorë periodikë, të organizuar në fund të çdo semestri ose viti, për të marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre mbi pedagogët, lëndët dhe stafin administrative; - o Përveç pyetësorëve, përmenden fokus-grupe si formë alternative për mbledhjen e mendimeve; 2. Reflektimi dhe përpunimi i të dhënave: - o Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen për qëllime përmirësimi; - o Rezultatet diskutohen në mbledhjet e njësive përkatëse (departament, fakultet) dhe ndahen me stafin, duke u adresuar sipas përgjegjësisë përkatëse; 3. Vënia në dispozicion e mekanizmave për ankesa dhe reagime: - o Parashikimi i ankimeve në aktet rregullatore të institucionit tregon për funksionalitet institucional dhe përkushtim për transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm; <i>Rekomandim, do të ishte e dobishme të dokumentohej më qartë frekuenca reale e mbledhjes së fokus-grupeve, si dhe masat e ndërmarra si rezultat i feedback-ut të studentëve, për të siguruar një cikël të plotë vlerësimi dhe përmirësimi të mësimdhënies.</i> Evidenca <i>Evidenca I.1 Statuti i UT,</i> <i>Evidenca I.5 Rregullore e UT,</i> <i>Evidenca II.8 Manuali i Cilësisë,</i> <i>Evidenca III.22-23, Raport vlerësimi vjetor për studentin dhe pedagogun nga NJSBC,</i> <i>Evidenca III.25 Model i pyetësorit të studentëve</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që	Korniza strategjike dhe normative është e pranishme dhe e përditësuar: o Institucioni ka përcaktuar në dokumentet strategjike

promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	(Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional, Strategjia e UT, Strategjia e FGJH, Rregulloret për sigurimin e cilësisë) që objektiv mbetet përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimi i burimeve përmes metodave moderne dhe interaktive të mësimdhënies. ○ Evidencat përfshijnë dokumente ligjore dhe rregullore që mbështesin ngritjen e strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë (NJSBC, GNB, Rregullore për sigurimin e cilësisë etj.). Struktura funksionale për sigurimin e cilësisë: ○ NJSBC (Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë) është ngritur dhe është funksionale në nivel institucional dhe të njësive kryesore. Ka përfaqësim nga pedagogë dhe studentë dhe është e angazhuar në monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. ○ Përfshihen instrumente të ndryshëm për vlerësimin e mësimdhënies si: pyetësorë të studentëve, fokus-grupe, vetëvlerësim i pedagogëve dhe vlerësim nga përgjegjësi i departamentit. Proceset e monitorimit dhe vlerësimit janë të institucionalizuara: ○ Aktivitetet e NJSBC përfshijnë analizën e feedback-ut nga studentët dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik. ○ Njësitë e sigurimit të cilësisë janë të funksionalizuara në nivelet përkatëse (fakultet, departament), sipas evidencave të vendimeve dhe urdhrave për ngritjen e tyre. Mangësitë dhe arsyet për vlerësim kryesisht: 1. Mungesa e evidencës për trajnime të vazhdueshme: ○ Nuk paraqiten evidenca konkrete që tregojnë trajnime të strukturuar, të vazhdueshme dhe të planifikuara për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies nga stafi akademik. 2. Mungesë e evidencës për eksperimentim dhe zhvillim të metodave të reja inovative të mësimdhënies:
---	---



	- o Në tekstin e RVB-së mungojnë shembuj konkretë ose dokumentim që vërtetojnë eksperimentim me metoda të reja, aplikime të teknologjisë digjitale, apo projekte të zhvillimit të metodave mësimore inovative. 3. Përqendrim i lartë te vlerësimi, jo te zhvillimi pedagogjik: - o Fokus më i madh është te monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies (feedback nga studentë, pyetësorë, etj.), por më pak te aspekti i zhvillimit profesional dhe pedagogjik të stafit. <u>Sugjerime:</u> <i>Hartimi dhe zbatimi i një programi të qëndrueshëm për zhvillimin profesional të stafit pedagogjik, me fokus në:</i> - o Trajnime për metodologjitë inovative. - o Zbatimin e mësimdhënies me bazë teknologjinë. - o Edukimi digjital dhe përvetësimi i metodave interaktive. <i>Dokumentimi dhe raportimi i praktikave të mira dhe inovative të mësimdhënies në nivel departamenti dhe fakulteti.</i> <i>Zhvillimi i një platforme institucionale për mbështetjen dhe shpërndarjen e metodave të reja të mësimdhënies, që mund të shërbejë si qendër burimore për pedagogët</i> Evidenca <i>Evidenca III.24 Struktura organizative e rektoratit të UT-së,</i> <i>Evidenca I.1 Statuti i UT, Kreu II, Kreu III neni 29, nenit 37, nenit 41-42,</i> <i>Evidencë II.9 Vendim i FGJH-së për ngritjen e NJSBC-së,</i> <i>Evidencë I.2 Strategjia e zhvillimit të UT-së</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se FGJH e realizon procesin e mësimdhënies, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin dhe duke rekrutuar personel akademik të pajisur me grada shkencore të nevojshme për mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve për programin e studimit;</i>

	<i>FGJH ka ngritur strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në të cilën janë përfshirë edhe studentët, megjithatë <u>GVJ rekomandon</u> që të dokumentohet më qartë frekuenca reale e mbledhjes së fokus-grupeve, si dhe masat e ndërmarra si rezultat i feedback-ut të studentëve, për të siguruar një cikël të plotë vlerësimi dhe përmirësimi të mësimdhënies;</i> <i><u>GVJ sugjeron</u> hartimin dhe zbatimin e një programi të qëndrueshëm për zhvillimin profesional të stafit pedagogjik, si dhe dokumentimin dhe raportimin e praktikave të mira dhe inovative të mësimdhënies në nivel departamenti dhe fakulteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Nga analiza e dokumentacionit dhe praktikave të zbatuara në programin Master i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, vlerësohet se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit janë të strukturuar dhe të formalizuara në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit të Tiranës, të cilat përmbajnë udhëzime të detajuara mbi komponentët e ndryshëm të vlerësimit, si provime, detyra kursi, prezantime, praktika mësimore dhe mbrojtje teze. Përveç përcaktimit të qartë të kriterëve, mënyrat e vlerësimit janë bërë publike dhe studentët informohen për to që në fillim të vitit akademik, duke siguruar kështu njohjen dhe njohshmërinë e plotë të rregullave të vlerësimit. Sistemi i vlerësimit është gjithëpërfshirës dhe i shumëllojshëm, duke përfshirë metoda formuese dhe sumative, të cilat ndihmojnë në vlerësimin gjithëpërfshirës të njohurive dhe kompetencave të studentëve. Gjithashtu, monitorimi i zbatimit të rregulloreve nga stafi akademik dhe studentët është i vazhdueshëm dhe sistematik, duke garantuar transparencë, barazi dhe cilësi në

	procesin e vlerësimit. Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-së,</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë II.1 Syllabuset e lëndëve,</i> <i>Evidencë III.27 Format e kontrollit të dijeve.</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga analiza e informacionit të ofruar dhe e evidencave përkatëse, rezulton se ky kriter përmbushet në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar nga programi Master i Shkencave “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”. Studentët pajisen me syllabusin përkatës në fillim të çdo lënde, ku janë të përfshira qartësisht të gjitha aspektet kryesore të procesit mësimor, përfshirë: emërtimi dhe kreditet e lëndës, objektivat e të nxëniet, temat përkatëse, format dhe metodat e mësimdhënies, detyrimet e studentit dhe – në mënyrë të veçantë – format e vlerësimit dhe metodologjia e testimit të njohurive. Syllabuset përmbajnë informacion të plotë dhe të standardizuar mbi raportin mes komponentëve të vlerësimit formativ dhe sumativ (provime, detyra, prezantime, pjesëmarrje, etj.), duke mundësuar transparencë dhe pritshmëri të qarta për studentët. Po ashtu, evidencat tregojnë se ky informacion nuk u komunikohet studentëve vetëm në mënyrë të shkruar, por edhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me pedagogët që në javën e parë të mësimet. Për më tepër, në kuadër të javës së orientimit, studentët informohen rreth strukturës së programit, mënyrave të vlerësimit dhe rregulloreve përkatëse, duke konsoliduar kështu kuptueshmërinë dhe përgatitjen e tyre për procesin akademik. Evidenca <i>Evidenca I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidenca I.21 Rregullore e programit të studimit,</i> <i>Evidencë II.1 Syllabuset e lëndëve,</i> <i>Evidencë III.21 Udhërrëfyeti i FGJH-së</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore	Duke iu referuar të dhënave të paraqitura në RVB dhe evidencave mbështetëse, konstatohet se sipas rregullores së programit, vlerësimi i studentëve nuk bazohet vetëm në një

realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	formë unike testimi, por është dinamik dhe i shumëllojshëm, duke përfshirë: • testime me shkrim dhe me gojë; • detyra kursi dhe ese; • prezantime individuale apo në grup; • praktika profesionale; • si dhe tezën përfundimtare të diplomës, e cila mbrohet pas përmbylljes së të gjitha detyrimeve të tjera akademike; Këto komponentë të shumtë të vlerësimit janë në përputhje me parimet bashkëkohore të arsimit të lartë, të cilat kërkojnë një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse në vlerësimin e studentëve, duke mbuluar aspekte njohurish teorike, zbatimi praktik, analizë kritike dhe aftësi komunikimi. Kjo metodologji i jep secilit student mundësinë për të demonstruar aftësitë dhe njohuritë e fituara përmes kanaleve të ndryshme, duke respektuar stile të ndryshme të të nxëniet dhe të shprehurit. Gjithashtu, shpërndarja e këtyre komponentëve përgjatë gjithë semestrit ndihmon në vlerësimin e vazhdueshëm (formativ) dhe jo vetëm në vlerësimin përfundimtar (sumativ), gjë që kontribuon në zhvillimin progresiv të kompetencave të studentëve. Në program përdoren forma të ndryshme dhe të kombinuara të testimit dhe vlerësimit, duke u dhënë studentëve mundësinë që të shfaqin njohuritë dhe kompetencat e tyre në mënyrë të plotë, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Evidenca <i>Evidencë I.5 Rregullore e UT-s,</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH-së,</i> <i>Evidencë III.29-30 Model teze me shkrim dhe me gojë,</i> <i>Shtojca Tabela 15</i> <i>Evidencë III.53 _Rregullore diplomimi e programeve studimore te ciklit të II Master i shkencave.pdf</i> <i>14. Programet Mësimore Master shkencor gjuhë turke.pdf</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se, kriteret dhe mënyrat e vlerësimit janë të strukturuar dhe të formalizuara në Rregulloren e Programit të



	<i>Studimit dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit të Tiranës;</i> <i>Forma e kontrollit të dijes nuk bazohet vetëm në një formë unike testimi, por është dinamik dhe i shumëllojshëm, duke përfshirë forma të ndryshme vlerësimi;</i> <i>Vlerësimi përgjatë gjithë semestrit ndihmon në vlerësimin e vazhdueshëm (formativ) dhe jo vetëm në vlerësimin përfundimtar (sumativ), gjë që kontribuon në zhvillimin progresiv të kompetencave të studentëve;</i> <i>Procesi i testimit dhe vlerësimit është i standardizuar, transparent, i shumëllojshëm dhe i orientuar drejt zhvillimit të kompetencave profesionale dhe shkencore të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar – përfshirë Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit të Tiranës, Rregulloren e programit të studimit, si dhe nga vëzhgimet dhe të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion – rezulton se kriteri në fjalë është përmbushur në mënyrë të plotë. Procesi i testimit dhe vlerësimit zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit akademik, duke siguruar kështu një ndjekje të rregullt të përparimit të studentëve. Komponentët e vlerësimit janë të specifikuar qartë në syllabuset e çdo lënde dhe aplikohen nga titullarët përkatës të moduleve, çka garanton koherencë në mënyrën e zbatimit të këtij procesi. Sistemi i përdorur për vlerësimin përfshin pikëzimin nga 0 në 100, i cili më pas konvertohet në një notë përfundimtare sipas sistemit 4–10 dhe kategorizohet me shkronja nga F deri në A. Ky sistem jo vetëm që është i strukturuar mirë, por gjithashtu siguron transparencë dhe objektivitet në vlerësimin e

	studentëve. Evidencat e paraqitura në raport dhe gjatë vizitës në institucion e mbështesin këtë qasje, duke dëshmuar se praktikrat e vlerësimit janë të institucionalizuara dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme. Evidenca <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT-s,</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FGJH-së,</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Gjatë vizitës u konstatua se një nga praktikrat më domethënëse është vlerësimi i sekretuar përmes përdorimit të barcode-ve gjatë provimeve, një mekanizëm që garanton objektivitetin dhe redukton mundësinë për ndërhyrje të padrejta në procesin e vlerësimit. Kjo praktikë përbën një shembull konkret të standardizimit të procedurave dhe ruajtjes së integritetit akademik. Gjithashtu, përdorimi i platformës Microsoft Teams për zhvillimin e testimeve online, veçanërisht në rrethana të jashtëzakonshme si pandemia, ka dëshmuar se institucioni është i aftë të përshtatet dhe të sigurojë vlerësim të drejtë, të shpejtë dhe të qasshëm. Ky sistem elektronik rrit ndjeshëm transparencën, objektivitetin dhe u mundëson studentëve të informohen në kohë për rezultatet e tyre. Dokumentet si Rregullorja e Përgjithshme e UT-së, Rregullorja e programit të studimit, rregullorja specifike për zhvillimin e provimeve online, si dhe të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në institucion, e mbështesin qartësisht faktin që këto mekanizma nuk janë vetëm të përshkruara në letër, por zbatohen në praktikë dhe janë pjesë e funksionimit të përditshëm institucional.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit mbështetës të ngarkuar në sistem, rezulton se Kriteri 3 – i cili kërkon që vlerësimi përfundimtar i lëndës të kryhet në përputhje me syllabus-in dhe bazën ligjore në fuqi – është kryesisht i përmbushur. Institucioni paraqet një strukturë të qartë dhe të dokumentuar të vlerësimit të studentëve, e cila përfshin komponentë të tillë si pjesëmarrja, detyrat e kursit, testet e pjesshme dhe provimi përfundimtar. Këto janë të përcaktuara në rregulloret e brendshme dhe në syllabuset e lëndëve, duke dëshmuar një përpjekje për të ndërtuar një kornizë të qartë dhe të drejtë

	vlerësimi. <i>Megjithatë, analiza tregon se kjo përputhje nuk është ende e plotë dhe e unifikuar në të gjitha lëndët.</i> Vetë raporti e pranon se ndarja e përqindjeve të komponentëve të vlerësimit ndryshon nga një lëndë në tjetrën dhe se ekziston nevoja për një tabelë njësuese të praktikave të vlerësimit që ende nuk është zbatuar në mënyrë të plotë. Mungesa e kësaj standardizimi të brendshëm krijon hapësirë për mospërputhje mes syllabusëve dhe praktikës konkrete të vlerësimit, duke rrezikuar koherencën dhe barazinë në vlerësimin akademik. <i>Për këtë arsye, rekomandohet që institucioni të punojë në drejtim të harmonizimit të plotë dhe të dokumentuar të formave dhe peshës së vlerësimit në të gjitha syllabuset, në mënyrë që procesi i vlerësimit të jetë sa më i unifikuar dhe në përputhje me standardet institucionale dhe legjislationin në fuqi.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në dokumentacionin institucional pasqyrohet qartë një kuadër që e lejon dhe e inkurajon dhënien e feedback-ut individual nga ana e pedagogëve. Kjo ndodh kryesisht nëpërmjet mundësisë për komente sqaruese pas vlerësimit, organizimit të konsultimeve të afishuara paraprakisht dhe të drejtës së studentëve për të parë tezën, për të analizuar rezultatet dhe për të ngritur ankime brenda një afati të përcaktuar. Këto mekanizma jo vetëm që garantojnë transparencën e procesit të vlerësimit, por edhe krijojnë hapësira reale për reflektim dhe përmirësim personal. Megjithatë, edhe pse këto praktika janë në funksion dhe të dokumentuara, përdorimi i feedback-ut pedagogjik nuk është i detyrueshëm dhe nuk duket se zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha lëndët apo nga të gjithë mësuesit. Mungesa e një praktike të standardizuar ose e mjeteve të strukturuar për ofrimin sistematik të komenteve formuese gjatë gjithë procesit mësues mbetet një aspekt që mund të përmirësohet. <i>Rekomandohet që institucioni të forcojë më tej këtë dimension përmes krijimit të udhëzimeve të brendshme apo instrumenteve praktike që do të inkurajonin përdorimin më të gjerë dhe të standardizuar të feedback-ut formativ si mjet për të nxitur të nxënësve reflektiv dhe përmirësimin e vazhdueshëm të studentëve.</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti i Tiranës, përmes Rregullores së Përgjithshme, Rregullores së programit të studimit Master i Shkencave – “Mësuesi në Gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, si dhe rregulloreve të posaçme për zhvillimin e provimeve, përfshirë ato online, ka përcaktuar qartë masat institucionale dhe administrative që ndalojnë dhe parandalojnë plagjiaturën dhe kopjimin në provime: • Rregulloret përmbajnë dispozita specifike mbi ndalimin e kopjimit dhe plagjiaturës, si dhe respektimin e Kodit të Etikës në UT; • Ndalohej hyrja në provime e personave të jashtëm, përveç autoriteteve të autorizuara, duke garantuar kontroll të rreptë të mjedisit të provimeve; • Pedagogët që shërbejnë në ruajtje gjatë provimeve janë të detyruar të raportojnë shkeljet e etikës dhe moralit nga studentët; • Fakulteti zbaton kërkesat e Rregullores së MASH për Etikën në veprimtarinë kërkimore dhe botuese (Nr. 105, datë 23.03.2012), duke vënë në dispozicion softëare antiplagjiaturë për kontrollin e punimeve të diplomës; Këto masa tregojnë një angazhim të qëndrueshëm institucional për të shmangur dhe parandaluar praktikat e papranueshme akademike dhe për të ruajtur integritetin etik dhe shkencor në të gjitha nivelet e procesit mësimor dhe kërkimor.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në Evidencat RVB-në dhe shënimeve të mbajtuara gjatë vizitës, GVJ vlerëson se kontrolli i dijeve dhe aftësive profesionale bazohet në: <u>Bazimi në meritë dhe objektivitet:</u> • Theksohet që vlerësimi i dijeve bëhet sipas rregulloreve në fuqi: Rregullorja e Përgjithshme e UT-së dhe ajo e programit të studimit; • Tezat janë të sekretuara, çka garanton objektivitet dhe shmang ndikimin subjektiv gjatë vlerësimit; • Vlerësimi i çdo komponenti të tezës bëhet me pikë, duke ndihmuar në një vlerësim të detajuar dhe të drejtë; <u>Respektimi i afateve të komunikimit të rezultateve;</u>



	• Rezultatet e provimeve me gojë jepen menjëherë, ndërsa ato me shkrim publikohen brenda 15 ditëve nga zhvillimi i provimit; • Procesverbalet dorëzohen brenda 5 ditëve nga afishimi i rezultateve, duke ndihmuar në përmbylljen me efikasitet të procesit; • Studentët njoftohen për rezultatet nga sekretaria mësimore ose nëpërmjet platformës online, çka tregon përdorimin e mjeteve moderne për transparencë dhe akses të shpejtë; <u>Garancia shtesë për transparencë dhe meritokraci përmes platformës online</u> • Kalimi në platformën Microsoft Teams dhe zhvillimi i provimeve online përmendet si faktor që rrit transparencën dhe sigurinë e vlerësimit; <u>Vlerësimi përfundimtar i studimeve</u> • Nota mesatare e ponderuar llogaritet duke marrë parasysh kreditet përkatëse, çka tregon një sistem të qëndrueshëm dhe të drejtë të përlllogaritjes së rezultateve përfundimtare; Për sa më sipër si dhe evidencat tregojnë që procesi i vlerësimit: • Bazohet në rregulla të qarta dhe transparente; • Realizohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme; • Komunikohet në kohë dhe përmes kanaleve të aksesueshme për studentët; • Mbështetet nga mjete dixhitale që forcojnë meritokracinë dhe kontrollin cilësor; <i>Rekomandim i vetëm për më tej: Ruajtja e vazhdueshme e transparencës dhe auditimi periodik i proceseve të vlerësimit, për të garantuar zbatimin praktik të të gjitha procedurave të përshkruara në dokumentacion.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në	Bazuar në tekstin e RVB dhe evidencat e ngarkuara në sistem, GVI konstaton se Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin nëpërmjet: 1. E drejta për transparencë të plotë mbi vlerësimin

përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	• Studentit i garantohet e drejta të njihet me pikët totale të tezës si dhe me pikët për çdo rubrikë, që është një element thelbësor i transparencës dhe përgjegjshmërisë akademike; • Në rast mospajtimi, studenti ka të drejtë të kërkojë sqarim për vlerësimin e bërë – një hap i qartë drejt garantimit të të drejtave të tij akademike; 2. Mekanizma të përcaktuar për rishikimin e vlerësimit • Në rast ankimimi, ngrihet një komision për rishikimin e provimit në prani të studentit, nga përgjegjësi i departamentit. Kjo procedurë siguron mbikëqyrje institucionale dhe garanton proces të drejtë e të paanshëm; • Komisioni për rishikim përbën një strukturë të qartë dhe funksionale, në përputhje me rregulloret përkatëse; 3. Ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit të vlerësimit • Fletoret e provimeve ruhen për një vit në departament, duke garantuar që dokumentacioni ekziston dhe është i aksesueshëm në rast të ndonjë ankimimi apo verifikimi të mëvonshëm; • Secili departament ka të përcaktuara rregullat për arkivimin, duke rritur kontrollin e brendshëm dhe përgjegjësinë administrative; <i>Rekomandim për më tej: Përmirësimi i aksesit digjital për ankimim dhe ndjekjen e statusit të rishikimeve përmes platformave të brendshme do të shtonte edhe më shumë transparencën dhe efikasitetin e këtij procesi.</i> Evidencat <i>Rregullorja e Përgjithshme e UT-së: përmban dispozita të qarta për ankimimin dhe transparencën.</i> <i>Rregullorja e programit të studimit: përcakton në mënyrë specifike procedurat në nivel departamenti.</i> <i>Dokumentacioni për ruajtjen e fletoreve dhe procesverbaleve është një masë për siguri institucionale dhe ndihmon në gjurmueshmërinë e vlerësimeve.</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë,	1. E drejta për ankim të garantuar dhe procedurë e qartë



ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	• Sipas nenit 50 dhe 51 të Rregullores së Përgjithshme të UT-së, studenti ka të drejtë: ◦ të ankohet për procedurën e zhvillimit të provimit; ◦ të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. • Afati për paraqitjen e ankesës është i përcaktuar: brenda • 48 orëve nga njohja me rezultatin, gjë që garanton respektimin e afateve të arsyeshme dhe parimeve të procesit të rregullt. 2. Strukturë dyfazëshe shqyrtimi: • Fillimisht, përgjegjësi i departamentit bën verifikimet përkatëse. • Nëse ankesa nuk zgjidhet në këtë fazë, ajo i kalon dekanit, i cili brenda 48 orëve ngre një komision ad-hoc (komision i posaçëm) për shqyrtimin e ankesës. • Ky komision, me miratim të dekanit, përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. Kjo ndjek saktësisht kërkesën e kriterit për shqyrtim nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm, duke e strukturuar procesin në mënyrë rigoroze dhe institucionale. 3. Transparencë dhe dokumentim • Procedura është e qartë dhe transparente, pasi: ◦ përcaktohen përgjegjësit institucionale (përgjegjësi i departamentit, dekani), ◦ parashikohet pjesëmarrja e palëve, ◦ vendimi përfundimtar dokumentohet nëpërmjet procesverbalesh. • Evidencat tregojnë se procesi dokumentohet dhe arkivohet, në përputhje me kërkesat ligjore dhe institucionale. 4. Zbatueshmëri në kushte të veçanta • Rregullorja e posaçme për provimet online përmendet si
---	---



	karrierës edhe për pjesëmarrje në leksione të hapura nga profesionistë të fushës, sipas fushave të studimit. Evidenca <i>Evidencë 1.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë V.19 Rregullorja e këshillit të studenteve të FGJH</i> <i>Evidencë 1.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë I.9 Raport vjetor mësimor-kërkimor 2021-2022</i> <i>Evidencë I.10 Raport vjetor mësimor-kërkimor 2022-2023</i> <i>Evidencë III.5 Leksion i hapur nga rektori Artan Hoxha</i> <i>Evidencë III.7 Leksion i hapur nga departamenti i gjuhës gjermane</i> <i>Evidencë III.15 klasa TEAMS technology trainings FGJH</i> https://fgjh.edu.al/keshilli-studentor
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ gjatë takimit me përfaqësuesit e Njesisë e Sigurimit të Cilësisë dhe shqyrtimit të dokumentacionit, vlerëson përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët reflektohen dhe analizohen në raporte për FGJH për të marrë më vonë masat e nevojshme për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe garantimin e sigurimit të cilësisë. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë 1.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë</i> <i>Evidencë III.26 Rregullore e NJSBC-FGJH</i> <i>Evidencë III.25 Model pyetësori me studentët</i> <i>Evidencë III.27 Tabela me përqindjet e vlerësimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	Mënyra e kontrollit dhe e vlerësimit të dijeve është pjesë përbërëse e syllabusit në çdo lëndë dhe ofron shpërndarjen e pikëve dhe të përqindjeve të vlerësimit sipas rubrikave përkatëse. GVJ konstatoi se studentët njihen me rezultatet e provimeve nga personeli akademik përgjegjës për lëndën përpara se ky vlerësim të vendoset në procesverbal nga sekretaria mësimore. Ata kanë të drejtë të rishikojnë provimin apo të kërkojnë rivlerësim nëse nuk janë të kënaqur me vlerësimin ose pretendojnë se meritojnë më shumë. Nëse edhe pas vlerësimit të dytë nga ana e personelit akademik studenti nuk është dakord me vlerësimin, ai ka të drejtë të bëjë ankim me

njësisë/pedagogut përgjegjës.	shkrim pranë sekretarisë mësimore. Megjithatë, gjatë gjithë vitit akademik studentët marrin vazhdimisht informacione lidhur me vlerësimin e provimit të ndërmjetëm, aktivizimit në seminare, detyrat e kursit dhe vlerësimin përfundimtar. Sekretaria mësimore dhe personeli akademik janë në dispozicion të studentëve për ti informuar mbi mënyrën e vlerësimit dhe format e ankimimit në rast pakënaqësie. Për vlerësimin përfundimtar dhe animimin, personeli akademik dhe studentët duhet të respektojnë afatet ligjore të përcaktuara në rregulloren e FGJH, rregulloren e UT dhe rregulloren e sekretarisë mësimore. Nga verifikimi i syllabuseve rezulton që formatet e tyre janë të unifikuara dhe format e kontrollit të dijeve të diversifikuara. Studenëve ju lihet kohë për argumentimin nga pedagogu i lëndës i vlerësimit, nëse kanë pakënaqësi për vlerësimin. Zhvillimi i seancave sqaruese dhe rishikimi i vlerësimit janë tregues i vëmendjes së institucionit ndaj transparencës me studentët gjatë procesit të vlerësimit. Evidenca <i>Evidencë 1.5 Rregullore e UT</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FGJH</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e brendshme e sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre në programin e studimit "Master në Mësuesi" në "gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë

Ikoceli

Buzajli

veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	FGJH ka krijuar të gjitha strukturat dhe procedurat e posaçme me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve si, Zyrën e informacionit, Sekretaria Mësimore, Zyra Këshillimit të Karrierës etj. FGJH zhvillon procedura konkrete dhe të qarta mbi informimin e studentëve, procedura këto të cilat rregullohen me akte të brendshme dhe që shkojnë në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studentët informohen mbi programin e studimit, procedurat e regjistrimit, organizimin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, transferimet apo pezullimet, kohëzgjatjen e studimit dhe tarifat, zhvillimin e procesit mësimor, strukturën akademike, shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor apo për çdo informacion tjetër që studentët mund të kërkojnë. Këto informacione ofrohen për studentët nëpërmjet sekretarisë mësimore, përgjegjësit të departamentit apo dekanit si edhe janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të FGJH dhe UT. Gjithashtu, në funksion të shpërndarjes së informacionit të studentët vijnë në ndihmë edhe broshurat informuese dhe udhërrëfyesit. Zyra e informacionit dhe zyra e këshillimit të karrierës janë gjithashtu në dispozicion të studentëve për ti informuar ata në çdo kohë. Gjatë periudhës së studimeve në dispozicion të studentëve departamenti përcakton një kujdestar për të ofruar këshillimin e nevojshëm sa herë që ata hasin vështirësi. Institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit” gjatë të cilës personeli akademik i departamentit i njeh studentët me programin. Evidenca <i>Evidencë 1.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë 1.21 Rregullore e programit të studimit MSHPTI</i> <i>Evidencë V.12 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët</i> <i>Evidencë III.37 Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidence III.28 Udhërrëfyes i FGJH</i> https://fgjh.edu.al/




	https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se FGJH ka ngritur një sistem informimi me në qendër studentin. Mbështetur në vizitat në FGJH rezultoi se informimi dhe këshillimi i studentëve kryhet nga struktura të ndryshme si sekretaria mësimore, zyra e këshillimit të karrierës, koordinatori për programin dhe zyra e kurrikulave. Gjithashtu, personeli akademik është vazhdimisht në komunikim me studentë jo vetëm në auditor por edhe në zyrë sa herë që është e nevojshme. Këshilli studentor luan një rol të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit duke i informuar dhe motivuar studentët për pjesëmarrjen në takimet informuese ose takime të tjera të cilat i shërbejnë rritjes së tyre profesionale dhe sociale, ku bëjnë pjesë përfshirja e tyre në aktivitete ekstra kurrikulare, në klube sportive, sociale apo akademike. Së fundmi, FGJH përditëson dhe publikon broshura informuese me informacione të përgjithshme mbi programin e studimit, personelin akademik, infrastrukturën dhe informacione të tjera si edhe i publikon ato në faqen zyrtare të internetit. Evidenca <i>Evidencë III.37 Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Evidencë V.21 Programi i transparencës për UT</i> https://fgjh.edu.al/ https://unitir.edu.al/njoftime/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në	GVJ konstatoi se UT dhe njësitë kryesore në FGJH kanë ngritur struktura të veçanta për pritjen dhe pranimin e studentëve në fillim të vitit akademik të cilat ndihmojnë studentët të informohen mbi programin e studimit, ciklet e studimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit, mundësitë e transferimeve, etj. Koordinator i programit u vjen në ndihmë studentëve gjatë periudhës së ndjekjes së studimeve. Struktura të tjera që vijnë në ndihmë në këtë aspekt janë edhe zyra e këshillimit të karrierës. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie dhe në takimin me studentët e programit mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave profesionale apo informime në lidhje me mundësitë e punësimit të tyre. Zyra e këshillimit të karrierës ndihmon të orientojë studentët

tregun e punës.	drejt tregut të punës duke i informuar ato për kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësojnë, shkrimin e letrës së motivimit ose CV si edhe i informojnë rreth pyetjeve të përgjithshme që mund të hasin gjatë intervistës së punës. Në panaiet e punës të organizuar nga njësia kryesore, studentët njihen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tregun e punës dhe institucionet ku mund të punësohen pas diplomimit. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT Vendim nr. 48 për qendrën virtuale të zhvillimi profesional dhe trajnimit</i> <i>Evidencë II.17 Studim i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja</i> <i>Evidencë II.29 Dosje e praktikës së studentit</i> <i>Evidencë III.8 dhe III.9 Leksion i hapur</i> <i>Evidencë III.12 Trajnime UT qendra virtuale e trajnimeve</i> <i>Evidencë III.49 Model marrëveshje, memorandum bashkëpunimi</i> <i>Evidencë V.12 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë së marrëdhënieve me studentët</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës pranë këtij institucioni shërben si një urë lidhëse mes studentëve dhe institucionit duke u dhënë mundësinë studentëve të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me tregun e punës dhe punëdhënësit, mban të dhëna mbi studentët e diplomuar lidhur me punësimin e tyre pas diplomimit ose angazhimin profesional që ata mund të kenë. Gjithashtu, kjo zyrë organizon edhe takime ose leksione të hapura me studentët ku të ftuar janë alumni i FGJH, kjo me qëllim ndarjen e eksperiencave dhe përfitimeve që këta mund të kenë pas diplomimit. Të dhënat e grumbulluara në formën e statistikave u vihen në dispozicion organeve drejtuese përkatëse, për zhvillimin e politikave institucionale dhe për arsye promovimi. Për të mbajtur një pasqyrë të saktë mbi punësimin e të diplomuarve, Zyra e Këshillimit të Karrierës disponon të dhëna statistikore të detajuara që pasqyrojnë suksesin e integritet të studentëve në tregun e punës.
	Zyra e Alumnit dhe Karrierës në FGJH ndjek studentët e diplomuar, komunikon me ta dhe ka siguruar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. Ky database i cili shërben institucionit për të vazhduar komunikimet me ta, nëpërmjet



	adresave të e-mailit kur kanë qënë studentë. Zyra e Alumnit dhe Karrierës zhvillon edhe sondazhe me studentët e diplomuar konform rregullave të UT dhe i pasqyron rezultatet në raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve të diplomuar. Zyra e Alumnit dhe Karrierës i mbledh studentët e diplomuar në aktivitete ku ata ndajnë përvojat e tyre dhe informacione për tregun e punës Evidenca <i>Evidencë II.17 Studim i tregut të punës për studentët e gjuhëve të huaja</i> <i>Evidencë V.12 Rregullore e komisionit të mbarëvajtjes së veprimtarisë së marrëdhënieve me studentët</i> <i>Evidencë III.12 Trajnime UT qendra virtuale e trajnimeve</i> <i>Evidencë III.8 dhe III.9 Leksion i hapur</i> <i>Evidencë V.14 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët e programin e studimit "Master në Mësuesi" në "gjuhën Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

130

Handwritten signatures and initials in blue ink.

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se në nivel institucional e kizon një qasje e strukturuar mjaft sigurt të cilësisë së mësimdhënies, e cila realizohet nëpërmjet vlerësimit periodic të lëndëve dhe reflektimit mbi rezultate të nxënësve. Në rastin konkret të degës së Gjuhës Turke si pjesë e Departamentit të Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike pranë FGJH, është evidentuar se vlerësimi i programeve të studimit dhe i lëndëve zhvillohet rregullisht të paktën një herë në tre vite ose sa herë që ndodhin ndryshime të konsiderueshme në përmbajtje. Ky proces zhvillohet në bashkëpunim me Dekanatin dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me kalendarin institucional dhe përmes dokumentacionit përkatës evidentohet cdo hap i ndërmarrë. Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies institucioni ka hartuar Dokumente specifike si manuali i cilësisë dhe rregullorja e sigurimit të cilësisë ofrojnë udhëzime për personelin akademik për të përmirësuar dhe garantuar cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollat e larta. Përfshirja e qasjeve të reja, mekanizmave dhe mjeteve teknologjike në procesin e mësimdhënies ndihmon në zhvillimin profesional të studentëve. Në FGJH funksionojnë grupe pune dhe njësi të sigurimit të cilësisë në nivel njësie kryesore ashtu edhe dhe nivel të njësisë bazë. FGJH përgadit periodikisht raporte mbi këtë proces, duke evidentuar mjetet, platformat dhe metodat inovative që përdoren nga personeli akademik gjatë mësimdhënies. Evidenca <i>Evidencë 1.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.8 Manuali i cilësisë</i> <i>Evidencë II.9 Vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i>
	<i>Evidencë VI.3 Vendimi i SA për miratimin e paketës së sigurimit të cilësisë në UT</i> <i>Evidencë VI.4 Vendimi i SA për ngritjen e grupit të punës për hartimin e manualit për sigurimin e brendshëm të cilësisë së UT</i>

	<i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi nga student, semestri parë dhe dytë</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se pranë FGJH përmes strukturave përkatëse akademike dhe administrative, ka zhvilluar dhe zbaton një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe vlerësimin e e aftësive procesit të mësimdhënies dhe qasjeve inovative. Këto struktura implementojnë mekanizma për monitorimin e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e personelit akademik dhe ndihmësakademik. NJSBC, harton pyetësorë periodikë për të monitoruar procesin mësimor. Këto pyetësorë ju shpërndahen studentëve dhe rezultatet e tyre i bëhen të ditur personelit akademik. Gjatë takimeve me përfaqësuesit e NJSBC u theksua fakti se çdo njësi bazë ka ngritur një strukturë të sigurimit të cilësisë përveç asaj të ngritur në nivel njësie kryesore. Çdo njësi kryesore harton raporte në kuadër të garantimit të sigurimit të cilësisë dhe FGJH dërgon në rektorat vetëm një raport të përbashkët. Procesi ka për qëllim të identifikojë nevojat për përmirësim në procesin mësimor dhe të promovojë zhvillimin profesional të stafit. Nga ana tjetër, manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik është një tjetër mekanizëm që FGJH përdor për të garantuar sigurimin e cilësisë, ku përcaktohen kriteret e vlerësimit të aftësive pedagogjike, metodat e zhvillimit të mendimit kritik të studentëve apo mënyrën e përdorimit të mjeteve teknologjike. Një tjetër mekanizëm që FGJH përdor për garantimin e sigurimit të cilësisë është edhe formulari i deklaratimit të aktivitetit shkencor nga personeli akademik përgjatë një viti akademik. Akte të tjera si manuali dhe rregullorja e sigurimit të cilësisë përcaktojnë kriteret e vlerësimit të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Evidenca <i>Evidencë VI.2 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC të FGJH</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi nga student, semestri parë dhe dytë</i> <i>Evidencë VI.12 Model i formularit të raportit të kërkimit shkencor për personelin akademik</i>

	<i>Evidencë VI.16 Vendim i SA mbi manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.17 Vendim i SA rregullorja mbi vlerësimin e performancës së personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Të dhënat e paraqitura nga FGJH tregojnë që përfshirja e studentëve në vlerësimin e formave të mësimdhënies kryhet në mënyrë periodike e në mënyrë të vazhdueshme. NJSBC harton pyetje sipas tematikave të caktuara dhe pas plotësimit të pyetësorëve nga ana e studentëve, analizohen të dhënat dhe më pas rezultatet u raportohen fillimisht personelit akademik dhe më pas dërgohen në rektorat. Vlerësimi i personelit akademik lidhet me performancën që ai ka në auditor dhe cilësinë e mësimdhënies. Nga takimi që GVJ pati me studentët u konfirmua që ky proces kryhej në vazhdimësi dhe me seriozitet. Ata dëshmuan se nuk kanë patur raste ankimimesh dhe se disponibiliteti i strukturave përgjegjëse nuk i'u mungonte. Evidenca <i>Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë II.25 Raport përmbledhës mbi pyetësorin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësorin formular vlerësimi nga student, semestri pare dhe dytë</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si edhe gjatë vizitave në institucion, GVJ konstatoi se pas plotësimit të pyetësorëve nga studentët, rezultatet e tyre u bëhen me dije personelit akademik nëpërmjet përgjegjësit të departamentit. Gjithashtu, në përfundim të vitit akademik, njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë harton një raport ku në mënyrë të detajuar paraqet analizën e gjetjeve, rekomandimet dhe sfidat e hasura. NJSBC bën një përmbledhje të raportit me rezultatet e vlerësimit të performancës së personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Dokumente të tilla si manuali i vlerësimit të performancës apo instrumentet e sigurimit të cilësisë janë publike jo vetëm për personelin akademik por edhe për studentët apo çdo palë e interesuar. Evidenca <i>Evidencë VI.3 Vendimi i SA për miratimin e paketës së sigurimit të cilësisë në UT</i>

	<i>Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë VI.13 Komisioni i përhershëm i sigurimit të standardeve të cilësisë së UT</i> <i>Evidencë VI.17 Vendim i SA rregullorja mbi vlerësimin e performancës së personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Pas takimeve të zhvilluara në FGJH dhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se institucioni përdor mekanizma për sigurimin e brendshëm të cilësisë, nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e procesit të mësimdhënies nga ana e studentëve dhe formularit të deklarimit të kërimit shkencor të zhvilluar nga personeli akademik gjatë një vitit akademik. NJSBC garanton identifikimin e praktikave më të mira dhe promovimin e tyre në nivel institucioni. Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimi i vazhdueshëm në disa nivele i personelit akademik përsa i takon metodave të mësimdhënies dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, punës kërkimore etj, nxisin stafin për përmirësim të vazhdueshëm të punës së tyre dhe promovojnë shembuj të praktikave të mira. Evidenca <i>Evidencë VI.2 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësorin formular vlerësimi nga student, semestri pare dhe dytë</i> <i>Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC</i> <i>Evidencë VI.12 Model i formularit të raportit të kërimit shkencor për personelin akademik</i> <i>Evidencë II.9 Vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërimit shkencor</i>			
Konkluzione	FGJH ka politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ofron dokumeenta specifike si manuali dhe rregullorja e cilësisë, të cilat ofrojnë udhëzime për personelin akademik për të përmirësuar standardet e mësimdhënies, dhe zhvillimit të metodave dhe monitorimit për programin e studimit "Master i Shkencave" në "Mësuesi gjuhë Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë".			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet



standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e FGJH janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. FGJH harton politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Më konkretisht politika e sigurimit të cilësisë është e përcaktuar qartë në manualin e cilësisë, rregulloren e vlerësimit të performancës së personelit ndihmës akademik dhe administrative dhe manualin e vlerësimit të performancës së personelit akademik. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është NJësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBC është përgjegjëse për hartimin e mekanizmave të cilat vlerësojnë cilësinë e mësimdhënies si edhe realizon përpunimin e të dhënave të mbledhura me qëllim vlerësimin e efikasitetit dhe cilësinë e programeve të ofruara. Standardet për sigurimin e cilësisë në FGJH janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Në startegjinë e zhvillimit të FGJH 2023-2028 janë përcaktuar objektiva të qartë dhe të matshëm lidhur me cilësinë e proceseve akademike. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.6 Strategjia e zhvillimit të FGJH</i> <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.8 Manuali i cilësisë</i> <i>Evidencë II.9 Vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë VI.2 Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik UT</i> <i>Evidencë VI. 5 Rregullore e NJSBC të FGJH 2022</i>

	<i>Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	UT ka ngritur NJSBC që funksionon në përputhje me planenin strategjik të institucionit, dhe në përputhje me rregulloret e programit të studimit. NJSBC si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe grantimin e cilësisë në UT është ngritur në nivel institucional dhe ka për detyrë vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore, nëpërmjet mbledhjes së raportimeve të njëjësive kryesore mbi këtë aktivitet. NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e UT, dhe realizon politikat, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në këtë universitet. Gjithashtu në rang institucional janë ngritur dhe formalizuar strukturat zyrtare të njohura si Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSSC), Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të cilësisë. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSSC), jep sugjerime dhe rekomandime në funksion të përmirësimit të cilësisë në institucion. Studentët janë të përfshirë në këtë proces duke ofruar mendim objektiv ndaj pyetjeve që u drejtohen dhe rekomandojnë përmirësimin e procedurave të caktuara. Mekanizmat për garantimin e cilësisë janë pyetësorët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe formularët e deklaratimit të aktivitetit kërkimor shkencor. Pyetësorët janë periodikë dhe rezultatet e tyre u bëhen me dije personelit akademik për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati UT</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC të FGJH 2022</i> <i>Evidencë nr 4 Dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>

Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.

FGJH përdor strukturat të caktuara brenda saj për realizimin e sigurimit dhe garantimit të cilësisë. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSSC), është mekanizmi tjetër që siguron dhe garanton cilësinë në FGJH.

Instrumenti që përdor UT për sigurimin e cilësisë është "Manuali i Cilësisë" i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me kodin e cilësisë. UT i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit nga autoritetet kombëtare në fund të vitit 2022. NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Për vlerësimin e procesit të mësimdhënies mbledhen të dhëna nga stafi akademik nga njësitë bazë dhe kryesore, nga studentët nga të diplomuarit nga stafi administrativ dhe mbi bazën e analizave krahasuese të tyre gjykohet për përmirësim të proceseve që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë janë të përfshirë si bashkëpunëtorë të jashtëm studentët e diplomuar dhe punëdhënësit. (Takimet në institucion me të gjithë përfaqësuesit e stafit akademik, administrativ dhe studentëve).

Evidenca

Evidencë VI.3 Vendim i SA për miratimin e paketës së dokumenteve të sigurimit të cilësisë në UT

Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati UT Evidencë VI.7, 8, 9, 10 Raport vjetor i NJSBC

Evidencë II.25 Raport përmbledhës për pyetësin

Evidencë VI.11 Model pyetësori të studentëve për pedagogun Evidencë VI.12 Model i formularit i raportit të kërkimit shkencor për personel akademik Evidencë VI.18 Vendim i SA për akreditimin periodik të programeve të studimit në UT

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve

Institucioni dëshmon se përdor instrumente të ndryshëm si tregues të matshëm të cilësisë të tillë si pyetësorë për vlerësimin e lëndës dhe mësimdhënies, raportime dhe analiza të pyetësorëve mbi kërkim-shkencor duke përdorur formuluarët e vetëdeklarimit që personeli akademik dorëzon në përfundim të çdo viti akademik dhe nëpërmjet vlerësimit që drejtuesi i njësisë bazë i bënë punës së çdo personeli akademik, anëtarit të njësisë e cila është një procedurë e standartizuar në institucionet e arsimit të lartë në

cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	vend. Strukturat e ngritura në FGJH bashkëpunojnë me njëra tjetrën për të garantuar një cilësi sa më të lartë të shërbimit akademik. NJSBC përdor metoda vlerësimi dhe instrumente vlerësuese, njësia bazë dhe njësia kryesore bashkëpunojnë për realizimin e pyetësorit dhe shpërndarjen te studentët, pasi e konsiderojnë procesin të rëndësishëm për evidentimin e problematikave si edhe përmirësimin e cilësisë. Një tjetër instrument i përdorur është edhe ai pyetësor i cili i është shpërndarë studentëve të diplomuar, duke e rritur nivelin e objektivitetit. Përgjegjësit e departamenteve e njohin personelin akademik me rezultatet e vlerësimit, më pas zhvillohen takime për të diskutuar rreth problematikave dhe merren masa për përmirësimin e situatës kur është e nevojshme. Evidenca <i>Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati UT</i> <i>Evidencë VI.11 Model pyetësori të studentëve për pedagogun Evidencë nr 4 dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor.</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet e realizuara gjatë vizitës në IAL, GVJ konkludon se institucioni ka politika dhe procedura transparente në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në programin e studimit “Master i Shkencave” në ‘Mësuesi gjuhë Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese	Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programeve të studimit është Drejtoria e Kurrikulave dhe NJSBC. Në nivel njësie bazë,



formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.

Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

është vetë Departamenti i Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike që ka programin e studimit “Master i Shkencave” në ‘Mësuesi gjuhë Turke për Arsimin e Mesëm të Lartë”, i cili së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve por dhe përgjegjësit e grup-lëndëve është përgjegjës për sigurimin e cilësisë. Mbështetur në vizitën që zhvilluam në institucion por dhe nga dokumentacioni i venë në dispozicion GJVJ konstatoi se ky institucion përdor mekanizma dhe procese specifike për granatimin e mbikqyerjes dhe programit të studimit si psh raportet vjetore, pyetësorët që plotësojnë studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, apo formularët që plotësohen për të deklaruar aktivitetin shkencor që janë zhvilluar gjatë vitit akademik si dhe mbledhjet periodike që zhvillon njësia bazë ku personeli akademik njihet me vlerësimet e pyetësorit. Vetë njësia bazë perfaqësohet me një koordinator i cili ruan komunikimin midis departamentit me NJSBC dhe Drejtorinë Kurrikulave që janë strukturat kryesore që bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën e tyre për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen e rishikimin e këtij programi. Në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë bazë, NJSBC mbikqyr efikasitetin e kurrikulave, pasqyrimin e tyre me korrektësi në programet lëndore, në formatin e vlerësimit të miratuar, dhe në literaturën e vënë në dispozicion të studentëve.

Raportet e realizuara nga NJSBCJ-ja vihen në dispozicion të strukturave drejtuese dhe stafit. Trajtimi i rezultateve të tyre në institucion bëhet në njësinë bazë të cilët diskutojnë marrjen e masave për zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e e programit brenda standarteve të kërkuara.

Evidenca

Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati i UT

Evidencë VI.11

Evidencë II.25 raport përmbledhës mbi pyetësorin 2021-2022

Evidencë VI.7, 8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësorin formular vlerësimi

Evidencë VI.15 Rregullore e brendshme e FGJH

Evidencë nr 4 Dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor

Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Monitorimi i procesit të përmbushjes së masave në kuadër të gjetjeve të konstatuara realizohet nga NJSBC-ja nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme nga personat përgjegjës, autoritetet drejtuese, nga diskutimet me stafin akademik si dhe pyetësorëve. Në raportet e hartuara evidentohen dhe raportohen çështje si: ✓ Cilësia e materialeve mësimore (literaturës); ✓ Cilësia e performancës së personelit akademik; ✓ Komunikimi pedagog-student; ✓ Konceptimi i transparencës në vlerësim; ✓ Përputhja e materialit lëndor me format dhe mënyrat e vlerësimit; ✓ Raporti teori/ praktikë në kurrikula, etj; Gjetjet ju bëhen me dije personelit akademik të departamentit dhe në mbledhjet e organizuara në këtë njësi ato bëhen objekt i analizës vjetore njëkohësisht raportet publikohen në faqen zyrtare të internetit. Në raport përfshihen rezultatet por edhe masat që duhet të merren në kuadër të garantimit të cilësisë, objektivat e së ardhmes për përmirësimin e procesit akademik dhe përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu, manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik është një mekanizëm i cili organizohet në disa pjesë dhe kryesisht trajton parimet, kriteret dhe periudhën e vlerësimit, hapa të cilat konkludojnë të gjithë procesin e sigurimit të cilësisë. Përveç personelit akademik, një rol shumë të rëndësishëm në FGJH luan edhe personeli ndihmës-akademik dhe ai administrativ. Në këtë kuadër, FGJH ka miratuar rregulloren mbi vlerësimin e performancës së personelit ndihmës-akademik dhe administrativ, në mënyrë që të drejtat, detyrimet dhe procedurat të jenë të qarta për të gjithë palët. Evidenca <i>Evidencë 1.1 statuti i UT</i> <i>Evidencë VI.16 vendim për miratimin e manualit të vlerësimit të personelit akademik</i> <i>Evidencë VI.17 vendim për rregulloren mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT</i> <i>Evidencë nr 4 Dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit</i>
--	--

	<i>shkencor</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	FGJH dhe vete dega e gjuhës turke për vlerësimin e mbarëvajtjes së programit të studimit përdorin metoda të drejtpërdrejta sikurse janë raportimet në nivel departamenti, vlerësimet periodike të procesit mësimor të kryera nga NJSBC si dhe monitorime në nivel institucional. Monitorimi dhe vlerësimi realizohen nëpërmjet pyetësorëve që u shpërndahen studentëve dhe analizës së rezultateve të përftuara prej tyre. Rezultatet e pyetësorëve analizohen dhe publikohen nëpërmjet raporteve vjetore. Departamenti dhe vete Dega e Gjuhës Turke organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të punës së Departamentit, ku krahas mendimeve të pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet e studentëve për lëndët dhe pedagoget. Institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve. Disa prej tyre janë: 1. Diagnostikimi i situatës ku njihet dhe vlerësohet i gjithë dokumentacioni që lidhet me fushën e cilësisë; 2. Përcaktimi i drejtë dhe koherent duke iu referuar procesit; 3. Hartimi i evidencave të qarta, kryerjes së ushtrimeve dhe projekteve nga studentë të gjuhës turke dhe më gjerë; 4. Përbushja dhe ekzekutimi i vlerësimeve paralele etj; Një tjetër mekanizëm i cili shërben si garantor i sigurimit të cilësisë në FGJH janë edhe vëzhgimet në auditor të cilat realizohen gjatë kryerjes së ushtrimeve dhe praktikave kryesisht në klasë dhe ndiqen nga personeli akademik. Këto vëzhgime ndihmojnë në identifikimin e elementëve të cilët nuk janë në përputhje me planin dhe në rast nevojë bëhen ndërhyrje të menjëhershme. Gjithashtu, analizohen rezultatet e arritura në testime kombëtare. Evidenca <i>Evidencë 1.9 dhe 1.10 Raport vjetor mësimor kërkimor</i> <i>Evidencë II.25 Raport përmbledhës mbi pyetësin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 dhe 9 raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi</i>

	<i>Evidencë II.23 Plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i> <i>Evidencë II.24 Plani i veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese 2022-2023</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC të FGJH 2022</i> <i>Evidencë VI.12 Model i formularit të raportit të kërkimit shkencor për personel akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Institucioni përdor instrumente vlerësues të drejtpërdrejt për didaktikën, kurrikulën, të mësuarit dhe provimeve Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përdor mekanizma për matjen e cilësisë nëpërmjet pyetsorëve dhe sondazheve dhe intervistave të kryera tek studentët për matjen, vlerësimin dhe cilësinë e programit. Pasi përpunohen dhe analizohen të dhënat e tyre kthehen në formën e raporteve të cila ju vihen në dispozicion strukturave drejtuese dhe personelit akademik. Nëpërmjet instrumenteve mbledhen edhe formular vlerësimi i studentëve për lëndën; por edhe i vetë pedagogëve për vetëvlerësimin e lëndës tyre. Në këto pyetsorë informacioni që synohet të mbledhet lidhet me: - Organizimin e lëndës; - Programin e lëndës; - Materialet e lëndës; - Komponentët e vlerësimit; - Pedagogu; - Materialet e mësimdhënies; - Performanca e klasës; - Vëzhgime; Gjithashtu vetë personeli akademik deklaron nëpërmjet një formulary të vetëdeklarimit aktivitetin kërkimor shkencor që ka realizuar gjatë një viti akademik. GVJ gjatë vizitës në institucion konfirmoi realizimin e tyre e këtyre instrumenteve matës si nga studentët ashtu edhe nga takimi me personelin akademik që shërben në programin e studimit.
	Evidenca <i>Evidencë II.21 Paketa e instrumenteve të cilësisë miratuar nga senati i UT</i>

	<i>Evidencë I.6 Strategjia e zhvillimit të FGJH 2021-2024</i> <i>Evidencë II.17 Studim i tregut të punës për studentët e FGJH</i> <i>Evidencë II.25 Raport përmbledhës mbi pyetësin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 dhe 9 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi</i> <i>Evidencë nr 4 Dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>			
Konkluzione	<i>FGJH monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit përmes metodave të drejtpërdrejta, dhe jo të drejtpërdrejta. Departamenti organizon takime mujore periodike për ecurinë e procesit mësimor, të cilat pasqyrohen në raportet vjetore të punës së Departamentit, ku krahas mendimeve të pedagogëve, përfshihen edhe vlerësimet e studentëve për lëndët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësiti akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	FGJH realizon politika dhe procedura të brendshme të cilësisë duke përfshirë disa aktorë në proces si: bordet e tregut të punës; ekspertë të jashtëm; përfshirja në projekte ndërkombëtare me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme si Erasmus +. Nga takimi në institucion, GVJ konfirmon se insitucioni garanton përfshirje të aktorëve të brendshëm dhe jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Sigurimi i brendshëm garantohet nëpërmjet përdorimit të mekanizmave vlerësues, analizimi i të dhënave të gjeneruara prej tyre dhe vlerësimi i jashtëm është një proces periodik i akreditimit dhe bashkëpunimit me agjencinë e sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, FGJH ngre grupe pune sa herë është e nevojshme për të garantuar cilësinë në këtë institucion, ku pjesë

	janë personeli akademik dhe studentët kur është e nevojshme, si është rasti i akreditimit institucional dhe akreditimit të programit të studimit. Bashkëpunimi me institucione të ndryshme që ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së FGJH konsiderohen gjithashtu mekanizma garantues të cilësisë. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.2 Strategjia e zhvillimi të UT Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë së IAL</i> <i>Evidencë II.8 Manuali i cilësisë E</i> <i>videncë VI.5 Rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë nr 4 Dokument shtesë formular mbi aktivitetin e kërkimit shkencor</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	FGJH ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për anëtarët përbërës të NJSBC, duke përcaktuar qartazi të drejtat dhe detyrat e tyre në proceset e sigurimit të cilësisë. Detyrat e NJSBC si struktura kryesore e sigurimit të cilësisë janë të përcaktuara qartë në rregulloren e saj. Duke qenë se pyetëtorët janë anonim, studentët mund të shprehin lirshëm dhe në mënyrë sa më objektive mendimet e tyre mbi procesin mësimor. Nga ana tjetër, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë pranë FGJH luan një rol shumë të rëndësishëm në këtë institucion pasi krijon një kulturë përgjegjësie për të ruajtur cilësinë e veprimtarisë akademike dhe garanton standardet e cilësisë të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi. Planet e punës të këtyre njësive tregojnë se këto detyra zbatohen në praktikë dhe GVJ e konfirmoi këtë edhe nga takimet në institucion. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë II.23 Plani i veprimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UT</i> <i>Evidencë II.9 Vendim i FGJH për ngritjen e NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së	Në vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit garantohej përfshirja e personelit akademik nga Departamenti i

programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Gjuhëve Sllave dhe Ballkanike Dega e Gjuhës Turke, njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit, stafit ndihmës administrativ dhe studentët. Studentët përfshihen nëpërmjet pyetësorëve, propozimeve të këshillit studentor dhe takimeve periodike me kujdestarët e programit. Vlerësimi i cilësisë është i brendshëm kur personeli akademik, administrativ dhe studentët angazhohen për shkrimin e raportit dhe mbështetjen e tij në evidenca konkrete që faktojnë të dhënat e deklaruara ndërsa vlerësimi i jashtëm kryhet nga agjencia e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Nga ana tjetër, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës garantojnë përfshirjen e njësisë kryesore në procesin e sigurimit të cilësisë së programeve që FGJH ofron. Metodologjia dhe procesi i hartimit të RVB e përshkruar në hyrje të raportit dhe e konfirmuar nga biseda me grupin e vlerësimit të brendshëm tregon përfshirjen e përfaqësuesve nga Departamenti, anëtarë të personelit akademik, nga personeli administrativ dhe një student i këtij programi studimi. Evidenca <i>Evidencë II.9 Vendimi i FGJH për ngritjen e NJSBC</i> <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë II.24 Plani i veprimtimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese 2022-2023</i> <i>Evidencë VI.17 Rregullorja mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ në UT</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	FGJH ka disa standarde të cilat i respekton për përzgjedhjen e anëtarëve në procesin e vlerësimit të njësive respektive si: kompetenca profesionale, paanshmëria, përfaqësimi për çdo njësi, rotacioni etj. FGJH garanton që vendimet të merren bazuar në aktet nënligjore në fuqi duke lënë mënjane gjykimet personale ose pabarazine. Aktet e brendshme e përforcojnë më shumë garantimin e cilësisë pasi këto procedura dhe standarde janë të parashikuara edhe aty. GVJ nga biseda me stafin akademik dhe zyrat respektive që merren me vlerësimet konfirmon se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhet në mënyre individuale për çdo personel akademik dhe problematikat në përgjithësi diskutoheshin në mbledhjet e Departamentit për të marrë vendime

	unanime. Evidenca <i>Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë nr 13 Dokumente shtesë</i> <i>Tabela 22 Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Proceset e vlerësimit të programit të studimit përfshijnë në diskutime edhe bashkëpunëtorët e Departamentit, të angazhuar si staf akademik i jashtëm, apo të atyre që monitorojnë praktikën e studentëve, të cilët janë përfaqësues të institucioneve partnere, apo ish student alumni. Mendimet dhe ekspertiza e tyre vjen nëpërmjet diskutimeve në mbledhjet e departamentit, aktivitetëve të përbashkëta, si projekte, konferenca, etj. GVJ e konfirmon këtë pas bisedave me stafin akademik efektiv dhe me kontratë të FGJH dhe konkretisht të programit të studimit si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyrojnë aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët. Gjithashtu, lidhur me integritetin akademik dhe identifikimin e punimeve shkencore të personelit akademik apo diplomave të studentëve FGJH nuk disponon një platformë për identifikimin e plagjiaturës apo Inteligjencës Artificiale. Sipas deklaratave të personelit akademik në takimet e zhvilluara në FGJH pjesa më e madhe e tyre gjejnë mënyra alternative të identifikimit të këtyre dy elementëve si përdorimi i platformave pa pagesë. GVJ e konsideron shumë të rëndësishëm ofrimin e këtij shërbimi për studentët dhe personelin akademik për respektimin e të drejtave të autorit. <i>Për sa më sipër, GVJ sugjeron implementimin e një platforme e cila identifikon detyrat e studentëve, temat e diplomës së studentëve dhe punimeve shkencore të personelit akademik përpara publikimit të tyre.</i> Evidenca <i>Evidencë I.11 Strategjia e ndërkombëtarizimit FGJH</i> <i>Evidencë I.12 Vendim për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026</i>

Konkluzione	GVJ konkludon se institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra. FHGJ ka përcaktuar standarde që të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve të përfshirë në proceset e vlerësimit. GVJ konfirmon se komunikimi i rezultateve të vlerësimit të stafit akademik bëhet në mënyre individuale për çdo personel akademik. GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyronte aktivitetet e përbashkëta të Departamentit me partnerët, vlerëson se partnerët janë pjesëmarrës në procesin e vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstatoi se FGJH nëpërmjet NJSBC garanton zbatimin e proceseve transparente dhe të ligjshme lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Vlerësimet dhe matjet e performancës bëhen në mënyrë periodike. Të dhënat pasi grumbullohen analizohen dhe më pas bëhen publike me raportimin dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të institucionit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garantohet edhe nëpërmjet përfshirjes në proces të personelit akademik, administrativ dhe të vetë studentëve të cilët shprehin lirshëm mendimin e tyre mbi problematika të caktuara. Evidenca Evidencë I.1 Statuti i UT Evidencë I.14 Rregullore për sigurimin e cilësisë IAL Evidencë VI.5 Rregullore e NJSBC dhe FGJH




	<i>Evidencë nr 13 Dokumente shitesë tabela 22 aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rregullorja e Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë në nenin 2 të saj përmban parimet mbi të cilën bazohet sigurimi i brendëshëm i cilësisë (evidenca 10). Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato elementë që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me personelin akademik ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJZHKC-së janë transparente dhe publikohen në seksionin e Sigurimit të Cilësisë në faqen e ëeb site-it të UniBAdhe në seksionin e Vlerësimit të Performancës. GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre. Evidenca <i>Evidencë I.1 Statuti i UT</i> <i>Evidencë I.12 Vendim për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026</i> <i>Evidencë II.25 Raport përmbledhës mbi pyetësin 2021-2022</i> <i>Evidencë VI.7, 8 Raport përmbledhës mbi pyetësin formular vlerësimi Evidencë VI.10 Raport vjetor i NJSBC dhe FGJH 2020-2021</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. GVJ konstatoi se FGJH ka miratuar akte të brendshme të cilat parashikojnë mënyrat e publikimit të rezultateve të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së institucionit. Publikimi bëhet duke respektuar parimet e lirisë dhe etikës profesionale dhe akademike si edhe parimin e anonimitetit. Të dhënat përpara se të publikohen analizohen dhe i bëhen me dije personelit akademik. Raportet e publikuara ndihmojnë në vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e cilësisë së institucionit. Gjithashtu, rezultatet e vlerësimeve diskutohen në mbledhje informuese me personelin akademik por edhe palë të tjera të interesuara me qëllim përmirësimin e kurrikulës dhe procesit të mësimdhënies. Nga shqyrtimi i evidencave disa nga masat e marra lidhen me aktivitete për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve akademike përmes realizimit të seminareve të trajnimit me natyrë didaktike të mësimdhënies apo për kërkimin shkencor.

	Evidenca <i>Evidencë VI.15 rregullore e brendshme e FGJH</i> <i>Evidencë VI.5 rregullore e NJSBC dhe FGJH</i> <i>Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të UniBa reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej. GVJ konstatoi se FGJH nëpërmjet strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë garanton këtë të fundit duke përdorur mekanizma vlerësues si pyetësorë dhe formularë vlerësimi të aktivitetit kërkimor shkencor. Pjesëmarrës në këtë proces janë personelit akademike, administrative dhe vetë studentët. Për të garantuar një proces sa më transparent dhe të drejtë, të dhënat e grumbulluara analizohen dhe u bëhen me dijeni strukturave drejtuese përpara publikimit në faqen zyrtare të institucionit. Studentët nga ana tjetër përfshihen në grupe pune apo komisione si edhe mbledhje ku trajtohen dhe marrin zgjidhje problematikat e tyre. Evidenca <i>Evidencë I.6 Strategjia e zhvillimit të FGJH</i> <i>Evidencë I.7 Rregullore e FGJH Evidencë I.14 rregullore për sigurimin e cilësisë IAL</i> <i>Evidencë I.11 Strategjia e ndërkombëtarizimit të FGJH</i> <i>Evidencë I.12 Vendim për miratimin e strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesit në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. Evidenca <i>Evidencë II.24 plani i veprimit për veprimtarinë monitoruese dhe vlerësuese 2022-2023</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për</i>

	<i>programin e studimit janë publike, transparente dhe efektive referuar faqes online të FGJH me informacion për aktivitetet në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Masteri Shkencave në: “Mësuesi në gjuhën turke për arsimin e mesëm të lartë”.

a. Pikat e forta;

1. Strukturë e qartë dhe në përputhje me standardet ligjore. Programi është i strukturuar si një cikël i dytë studimesh dhe respekton kërkesat ligjore për programet master në mësuesi;
2. Programi është unik në Shqipëri dhe për këtë edhe i vetmi që përgatit specialistë të fushës;
3. Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencën dhe kualifikimet e duhura, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit;
4. Angazhim i studentëve në kërkimin shkencor dhe ndërkombëtarizim. Studentët marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera si pjesë e projekteve me TIKa dhe TÛBÏTAK; gjithashtu, ka mobilitet të mirë nëpërmjet Erasmus+;
5. Kontribut akademik dhe kulturor i stafit pedagogjik. Përkthimet dhe botimet e stafit janë vlerësuar nga Ministria e Kulturës, çka tregon për përfshirjen aktive në fushën akademike dhe atë të përhapjes së kulturës;
6. Programit ofrohet nga një ambient i pajisur me laboratorë të mirë, me mjetet didaktike moderne që ndihmojnë në një mësimdhënie bashkëkohore;
7. Përputhshmëri e programit me nevojat e tregut. Programi synon përgatitjen e mësuesve për shkollat e mesme në Shqipëri dhe për institucionet arsimore turke në vend, duke mbuluar një fushë me kërkesë reale;

b. Pikat e dobëta:

1. Ne planin mësimor të këtij program studimi, mungojnë lëndët bazë të kategorisë A, sipas akteve ligjore në fuqi (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018); *(Standarti II.1, kriteri 1)*
2. Në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi konsatohet staf akademik me Msc, në kundërshtim me nenin 59 /6 të Ligjit nr. 80/2015, ku kërkohet që stafi akademik të ketë të paktën gradë shkencore (Dr); *(Standarti IV.1, kriteri 1)*
3. Literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar në disa nga syllabuset mund të konsiderohet e vjetërsuar dhe e mbi dhjetë viteve të fundit; *(Standarti IV, 3; kriteri 4)*

Rekomandime

1. GVJ sugjeron, që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës përkatëse në kredite me qëllim që të përputhet me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018;
2. GVJ rekomandon që institucioni duhet të marrë masat që në mësimdhënien e këtij program studimi të angazhohet vetëm staf akademik me kualifikimin “Dr” në përputhshmëri me aktet ligjore;
3. GVJ sygjeron që të pasurohet Biblioteka me botime të viteve të fundit si nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj në fushën e studimeve të gjuhës dhe historisë turke, të cilat duhet të vendosen edhe në syllabuset e lëndëve për të mundësuar plotësimin e lëndëve me literaturë të 5 viteve të fundit, gjë që në një pjesë të tyre mungon;
4. Rekomandohet të dokumentohet më qartë frekuenca reale e mbledhjes së fokus-grupeve, si dhe masat e ndërmarra si rezultat i feedback-ut të studentëve, për të siguruar një cikël të plotë vlerësimi dhe përmirësimi të mësimdhënies;
5. GVJ sugjeron hartimin dhe zbatimin e një programi të qëndrueshëm për zhvillimin profesional të stafit pedagogjik, si dhe dokumentimin dhe raportimin e praktikave të mira dhe inovative të mësimdhënies në nivel departamenti dhe fakulteti;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences on:
"Turkish language teacher for higher secondary education".

a. Strengths of the Program:

1. A clear structure in compliance with legal standards – The program is structured as a second-cycle study program and meets the legal requirements for master's programs in teaching.
2. The program is unique in Albania and therefore the only one preparing specialists in the field.
3. The academic staff involved in the study program possesses the necessary experience and Qualifications to fulfill the objectives of the study program.
4. Student engagement in scientific research and internationalization – Students participate in international conferences and other activities as part of projects with TIKA and TÜBİTAK; additionally, there is good mobility through Erasmus+.
5. Academic and cultural contribution of the teaching staff – Staff translations and publications have been recognized by the Ministry of Culture, showing active involvement in academic work and cultural dissemination.
6. The program is supported by facilities with well-equipped laboratories and modern didactic tools that aid contemporary teaching.
7. Alignment with labor market needs – The program aims to prepare teachers for secondary schools in Albania and for Turkish educational institutions in the country, addressing a real area of demand.

Weaknesses:

1. The curriculum of this study program lacks core subjects from Category A, as required by the applicable legal acts (Decision of the Council of Ministers No. 41, dated 24.01.2018); (*Standard II.1, Criterion 1*)
2. In the teaching process of this study program, academic staff holding only an MSc degree have been identified, which is in contradiction with Article 59/6 of Law no. 80/2015, which requires that academic staff hold at least a doctoral degree (PhD); (*Standard IV.1, Criterion 1*)
3. The mandatory and recommended literature in some of the syllabi can be considered outdated, mostly older than ten years; (*Standard IV, 3; Criterion 4*)

Recommendations

1. The External Evaluation Group (EEG) suggests that the distribution of the corresponding credit load be revised in order to align with the provisions of Decision of the Council of Ministers No. 41, dated 24.01.2018;
2. The External Evaluation Group (EEG) recommends that the institution should take measures to ensure that only academic staff holding a "Dr" qualification are involved in the teaching of this study program, in accordance with the legal provisions;
3. The External Evaluation Group suggests that the library be enriched with recent publications from the last five years by both Albanian and foreign scholars in the field of Turkish language and history studies. These publications should also be included in the course syllabi to ensure that the subjects are supplemented with up-to-date literature, which is currently lacking in some of them;
4. It is recommended that the actual frequency of focus group meetings, as well as the measures taken as a result of student feedback, be more clearly documented in order to ensure a complete cycle of teaching evaluation and improvement;
5. The External Evaluation Group suggests the development and implementation of a sustainable program for the professional development of the academic staff, as well as the documentation and reporting of good and innovative teaching practices at the department and faculty level;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X